



## Gjenerallejtënant Kingji:

FARSH, të angazhuar për bashkëpunimin me partnerët dhe rritjen e ndërveprueshmërisë për një menaxhim efektiv të sfidave të sigurisë





**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel Shef Shtabi, të mbajtur në Selinë e NATO-s, Bruksel, Belgjikë. Fokusi i këtij takimi ishte fuqizimi i masave të shkurajimit dhe mbrojtjes, zhvillimi i bashkëpunimit me vendet partnere të NATO-s, dhe mbështetja e Ukrainës në rezistencën ndaj sulmit të paprovokuar rus.

Takimi u drejtua nga kryetari i Komitetit të NATO-s, admiral Rob Bauer, me mbështetjen e komandantit Suprem të Aleancës për Operacionet, gjeneral Christopher Cavoli, dhe komandantit Suprem të Aleancës për Transformim, gjeneral Pierre Vandier.

Në hapjen e punimeve të takimit ishte i pranishëm edhe Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, Mark Rutte, i cili në fjalën e tij theksoi se nëse duam paqe, duhet të përgatitemi për luftë, dhe se ka ardhur koha për të kaluar në një mendësi të kohës së luftës. Kjo, vijoi ai, do të kërkojë shpenzime në rritje për mbrojtjen, vijim të mbështetjes për Ukrainën, dhe fuqizim të bashkëpunimit me partnerët në mbarë botën.

Në vijim mori fjalën admiral Bauer, i cili theksoi domosdoshmërinë për të mbështetur Ukrainën, mbështetja e cila është në interes të përmbushjes së objektivave politike dhe ushtarake të Aleancës.

Agjenda e këtij takimi përfshinte gatishmërinë e NATO-s për shkurajimin dhe mbrojtjen në zonën Euro - Atlantike, misionet dhe operacionet aktuale, procesin e planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s, implementimin e udhëzuesit për mundësimin e Aleancës për të kryer operacione shumë-domenesh brenda 2030, standardizimin dhe ndërveprueshmërinë si elementë të rritjes së efektivitetit të vendeve partnere me Aleancën.

Në ndërhyrjet e tij gjatë seancave të këtij takimi, gjenerallejtënant Kingji ofroi një panoramë të masave të marra nga vendi ynë në kuadër të shkurajimit dhe mbrojtjes, kapacitetet e vendit tonë për mbështetjen e operacioneve dhe lëvizshmërinë ushtarake, kontributin në operacionet dhe misionet e drejtuara nga Aleanca, dhe mbështetjen e ofruar për Ukrainën.

Ai vlerësoi bashkëpunimin me vendet partnere si të domosdoshëm për sigurinë përtej kufinjve të Aleancës, nisur nga ndërthurja e sigurisë rajonale me atë globale.



## GJENERALLEJTËNANT KINGJI:

FARSH, të angazhuar për bashkëpunimin me partnerët dhe rritjen e ndërveprueshmërisë për një menaxhim efektiv të sfidave të sigurisë



Angazhimi i tyre në operacionet dhe misionet e Aleancës, ndër të tjera KFOR dhe NSATU është një vlerë e shtuar për forcimin e sigurisë në zonën Euro- Atlantike. Gjenerallejtënant Kingji theksoi angazhimin për të rritur bashkëpunimin

me partnerët dhe rritjen e ndërveprueshmërisë për një menaxhim efektiv të sfidave të sigurisë.

Përtej angazhimit në këto sesione, gjenerallejtënant Kingji zhvilloi takime të veçanta me Shefin e SHPFA të Turqisë, gjeneral

Metin Gürak, të Suedisë gjeneral Michael Claesson, dhe të Sllovenisë gjenerallejtënant Robert Gllavas, gjatë të cilave u diskutua mbi bashkëpunimin ushtarak dypalësh dhe mundësitë për nxitjen e tij në të ardhmen.





# MINISTRI VENUGU:

Partneriteti strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA-së, prioritet kryesor në politikat tona të sigurtisë

**M**inistri i Mbrojtjes z. Piro Vengu, priti në ambientet e Komandës së Forcës Detare/Rojës Bregdetare dhe Qendrën Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare, të dërguarën me punë të SHBA-ve në Shqipëri, znj. Nancy Van Horn.

Ministri Vengu, duke shprehur kënaqësinë e tij për këtë takim tha: “Partnerët tanë janë të pranishëm në të gjitha proceset e zhvillimit të kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe takimi me znj. Van Horn u fokusua në disa tema të rëndësishme si bashkëpunimi në çështjet e sigurtisë dhe mbrojtjes, forcimi i kapaciteteve tona mbrojtëse dhe sfidat e përbashkëta.

Partneriteti strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA-së mbetet një prioritet kryesor në politikat tona të sigurtisë. Ky bashkëpunim është themelor për zhvillimin dhe modernizimin e forcave tona të armatosura.

Znj. Van Horn u njoh gjithashtu me misionin, sfidat dhe projektet e rëndësishme që kemi për të ardhmen e strukturave tona detare. Mbështetja e SHBA-ve vijon të jetë jetike për përmirësimin e sigurtisë dhe mbrojtjes sonë kombëtare.



## FUSHË E RE SPORTIVE

në Garnizonin ‘Skënderbej’ për Forcat e Armatosura

Investimet infrastrukturore të Forcave të Armatosura vazhdojnë me ritme të shpejta. Një prej tyre është dhe fusha e re sportive në garnizonin “Skënderbej”, e cila po merr formë sipas standardeve më të larta. Ky është një investim i rëndësishëm që synon të ofrojë kushte optimale për përgatitjen fizike të personelit, duke reflektuar angazhimin tonë për modernizimin e infrastrukturës së Forcave të Armatosura. Punimet për përmirësimin e infrastrukturës që përfshirë parkingjet, postbllokun dhe fushat sportive, janë drejt përfundimit dhe pritet të përmbyllen brenda muajit mars 2025.





# Urat “BAILEY”, misioni vazhdon...

**M**inistri i Mbrojtjes, Pirro Vengu u shpreh se gjatë vitit 2025, planifikohet që të ndërtohen 12 ura të reja “Bailey” në disa nga zonat e vendit, ku ato janë më të nevojshme. Urat, si pjesë që lidhin komunitetet, ndihmojnë jo vetëm në çështjet e sigurisë, por edhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve në çdo cep të Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura do të vazhdojnë misionin për ndërtimin e tyre. Gjatë vitit 2024 janë ndërtuar tetë ura “Bailey” me gjatësi totale prej 207 metrash, duke lidhur komunitete të izoluar dhe lehtësuar jetën e banorëve.

“Plani për 2025 është edhe më ambicioz: 12 ura të reja do të ndërtohen në zonat më të nevojshme të vendit. Puna ka nisur me urën e re mbi lumin Lezedër, në fshatin Fshat të Bashkisë Klos”, - informoi ministri i Mbrojtjes.

Me ritme të larta dhe angazhim të përbashkët, do të vazhdojmë të afrojmë njerëzit dhe të ofrojmë zgjidhje konkrete për sfidat e përditshme të komuniteteve tona”, - përfundoi ministri Vengu.



## U zhvillua Konferenca Finale e Planifikimit për projektin “FloodNorthALB”

Konferenca Finale e Planifikimit për projektin “FloodNorthALB”, një nismë e rëndësishme që synon të trajtojë përmbajtjet komplekse në Qarkun e Shkodrës dhe të forcojë kapacitetet e reagimit ndaj fatkeqësive të mëdha në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor, u zhvillua përgjatë dy ditëve në ambientet e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky projekt, i mbështetur nga Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së, vë theksin te gatishmëria, bashkëpunimi ndërkufitar dhe përmirësimi i procedurave për menaxhimin e emergjencave.

Pjesëmarrësit diskutuan për planifikimin e ushtrimit të përbashkët, masat logjistike dhe sigurinë, duke u fokusuar gjithashtu te rëndësia e marrëdhënieve me publikun dhe medias në situata emergjente.

Shqipëria, si një anëtare e re e Mekanizmit të BE-së, po luan një rol të rëndësishëm në forcimin e sistemit rajonal të mbrojtjes civile, duke kontribuar në ndërtimin e një të ardhme më të sigurt për qytetarët.







ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

### Bëhu ndryshimi i jetës tënde! Voto qytetarisht!

‘Vota është një e drejtë e gjithsecilit për të shfaqur mendimin e tij në kohën kur mbahen zgjedhjet. Në njërën anë ndodhet Mendimi, në tjetrën qëndron Vota. Mendimi përkthehet në votë dhe vota shndërrohet në përfaqësim të mendimit që ka gjithsecili. Pra, përmes votës njeriu përcjell mendimin e tij’. Zgjedhjet shërbejnë për vendosjen e ekuilibrave të duhur në politikën shqiptare, në mënyrë që vendi të njohë stabilitet dhe proceset integruese të vijnë. Gjithashtu, vendi duhet të njohë përfaqësim dinjitoz në trupat diplomatike, rritje të shkallës së përgjegjësisë për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve dhe çështjet e tyre në Ballkan, zhvillimin dhe garantimin ekonomik, rritjen e mirëqenies sociale, ngritjen e stadit të minimumit jetik etj.

Çdo palë zgjedhje, qofshin parlamentare apo lokale, nuk janë detyrim ligjor por detyrim qytetar, detyrim kombëtar, detyrim kushtetues, detyrim emancipues, detyrim familjar e farefisnor. Një votë masive, një pjesëmarrje e gjerë sjell veçse pozitivitet. Askush nuk mund ta cenojë pjesëmarrjen masive në zgjedhje.

Edhe nëse faktorë të ndryshëm politik, të pistë deri në palcë, por edhe qytetarë mjeranë të tentojnë të tjetërsojnë votën, sërish nuk do të kenë forcën për ta ndryshuar drejtimin e saj, nëse populli merr pjesë masivisht në votime. Kështu, çdo shqiptar me të drejtë vote, më 11 maj duhet të votojë, si një detyrim ndaj vetes dhe kombit të tij dhe për këtë duhet të ndërgjegjësohemi si shoqëri për rëndësinë dhe vlerën jetike të tyre. Vetëm kështu mazhorancat qeverisëse do të jenë më konstruktive dhe të pranueshme, pasi shumica e shqiptarëve do të dalin në zgjedhje.

Le të hedhim vështrimin mbi vendet me demokraci të kulluar! Të gjitha, pa përjashtim, kanë një pjesëmarrje në zgjedhje mbi 80 për qind. Kjo tregon se një popull i kulturuar duhet të shkojë në votime, një popull demokratik duhet të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së tij, një popull intelektual duhet të peshojë fatin e tij përmes votës sublime.

Pra, kjo është një votë deliberative, më se e nevojshme për të ndrequr a rregulluar, përmirësuar apo progresuar jetesën e secilit prej shqiptarëve. Një arritje e zgjedhjeve të 11 Majit 2025 është dhe vota e emigrantëve, e cila pas shumë përpjekjesh po bëhet realitet.

Duke jetuar në vende me demokraci të përparuar, emigrantët janë më të ftohtë në gjykimin e tyre. Ata në pjesën më të madhe i shohin ngjarjet politike dhe situatat që ata sjellin, pa skepticizëm dhe pa militantizëm, por kur bëhet fjalë për demokracinë e rrezikuar dhe cilësinë e jetës të munguar për të afërmit e tyre në Shqipëri, janë të aftë të reagojnë me armën e vetme që kanë në dorë, votën.

### Pse është e rëndësishme të votosh?

Jetojmë në një shtet, ku gëzojmë të drejtën të votojmë për njerëzit që do të na përfaqësojnë në parlament. Në shumë vende, e drejta e votës (sidomos për gratë) nuk ekziston.

Me votë vendosim për cilësinë e jetës tonë dhe për brezat e ardhshëm, të paktën për 4 vitet e ardhshme. Vota është mënyra juaj për të adresuar problemet.

Zgjedhjet janë procesi ku rezultati varet nga njerëzit që votojnë. Edhe nëse të zgjedhësh që të mos votosh duket si një formë votimi, kujtoni që kur numërohen votat, vota e dikujt që ka votuar ka më shumë peshë. Është matematikë e thjeshtë, kështu funksionon, ndodh që qeveritë e këqija zgjidhen nga njerëzit e mirë që zgjedhin të mos votojnë.

Paguan taksa? A nuk dëshiron që të vendosësh se si do të shpenzohen paratë e tua dhe kush do t’i menaxhojë? Vota nuk është thjesht të zgjedhësh kush do qëndrojë në zyrat e ministrive dhe kaq.

# “Nëse nuk voton, ke humbur të drejtën për të kundërshtuar”



Fëmijët, nën 18 vjeç nuk mund të votojnë. Kështu që shumë të tjerë nuk e dinë se votimi është edhe përgjegjësi ndaj njerëzve që nuk e kanë këtë privilegj. Përpos kësaj, prindërit duhet t’u mësojnë fëmijëve, përmes shembullit të tyre, rëndësinë e votimit si e drejtë e zgjedhjes dhe vendimmarrjes.



PËRMES VOTËS NJERIU PËRCJELL MENDIMIN E TIJ’. ZGJEDHJET SHËRBEJNË PËR VENDOSJEN E EKUILIBRAVE TË DUHUR NË POLITIKËN SHQIPTARE, NË MËNYRË QË VENDI TË NJOHË STABILITET DHE PROCESET INTEGRUESE TË VIJOJNË. GJITHASHTU, VENDI DUHET TË NJOHË PËRFAQËSIM DINJITIZ NË TRUPAT DIPLOMATIKE, RITJE TË SHKALLËS SË PËRGJEGJËSISË PËR TË MBROJTUR TË DREJTAT E SHQIPTARËVE DHE ÇËSHTJET E TYRE NË BALLKAN, ZHVILLIMIN DHE GARANTIMIN EKONOMIK, RITJEN E MIRËQENIES SOCIALE, NGRITJEN E STADIT TË MINIMUMIT JETIK ETJ.

### Si zgjedhim ne?

Gjithsecili ka një përgjigje të ndryshme ndaj pyetjes: ‘Cili aset ka më shumë rëndësi për një parti politike?’ Disa mund të përgjigjen: ‘Një udhëheqës karizmatik’. Të tjerë mund të thonë: ‘Një mesazh i shkëlqyer’ apo ‘Shumë para’. Përgjigjja ime është: ‘Një anëtarësi e madhe dhe në rritje’. Një parti që ka vetëm një udhëheqës, një mesazh dhe një shumë parash është një parti që nuk ka shanse të jetë e suksesshme për një kohë të gjatë, sepse anëtarësia e partisë është pusi prej nga nxirren veprimtarët, kandidatët dhe udhëheqësit e ardhshëm. Anëtarët janë burim idesh, energjie dhe rritje të mundshme. Ata janë mjetet me të cilat partia mund të jetë aktive në nivel vendor, duke mbajtur një dialog të vazhdueshëm me qytetarët në periudhat ndërmjet zgjedhjeve. Anëtarët e partisë mund parandalojnë udhëheqësit e një partie qeverisëse të humbasin lidhjen me zgjedhësit dhe nga ana tjetër mund të parandalojnë udhëheqësit e opozitës të humbasin shpresën për fitore në të ardhmen. Anëtarët e partisë janë aseti më i rëndësishëm, sepse pa ta nuk ka parti. Nëse anëtarët janë aseti më i vyer që mund të ketë një parti, atëherë organizatorët e saj duhet të kenë parasysh se si t’i anëtarësojnë, si t’i mbajnë, si t’i motivojnë dhe si t’u japin detyra sa më me efektivitet.

### Çfarë të bën qytetar të denjë?

Hedhja e VOTËS në kuti ditën e zgjedhjeve! Problemi qëndron se jo çdo shqiptar e respekton këtë detyrë... Shpesh vota shkelet me këmbë dhe vlerat e saj morale dhe idealiste janë humbur. Jo rrallë herë është hedhur në treg dhe shitet ashtu rëndomtë, me tabelën e çmimit të boshatisur, që të mbushet me çmimin e atij që ofron më shumë. Një turp...

Ka ardhur momenti që të gjithë së bashku, ta përdorim votën si të vetmen mburojë dhe armë që kemi. Më 11 Maj, të gjithë t’i drejtohem qendrave të votimit me mendimin e vetëm që votën do ta hedhim aty ku ne mendojmë që do të na shërbejë më mirë. Sidomos femrat, si pjesa e shoqërisë që për shekuj i është mohuar e drejta për të votuar, duhet të jenë ato të parat që të thonë me zë të fortë që VOTA S’KA ÇMIM! Duhet të jenë të rinjtë dhe të rejat, për një të ardhme më të mirë dhe më të ndritur.

*Voto për përparimin!*





# ARTILERIA SHQIPTARE

“gryka e zjarrit” në tokë, det, ajër

Më 28 nëntor 1912, me Shpalljen e Pavarësisë dhe krijimin e shtetit shqiptar pas gati 5 shekuj robërie nga pushtuesit otomanë, është akti më madhor që rilindësit tanë, të prirë nga Ismail Qemali, realizuan në një kohë tepër të vështirë për gadishullin Ballkanik, i cili ishte përfshirë nga lufta e parë ballkanike dhe shqiptarët ishin në gjendjen e rëndë, se kishte rënë perandoria otomane, rrezikonin ekzistencën e tyre nga oreksi i shteteve fqinjë për pushtimin e copëtimit të saj. Një nga përparësitë e qeverisë të dalë nga Kuvendi i Vlorës, për kushtet aktuale ishte krijimi i ushtrisë, e cila u vendos në mbledhjen e 4 dhjetorit 1912, me emërimin e Gjeneral Mehmet Derrallës, në postin e Ministrit të Mbrojtjes. Më 4 maj 1913, u njoftua krijimi i Shtabit Madhor të ushtrisë shqiptare me kryetar Major Ali Shefqeti. Koha e veprimtarisë së qeverisë së I. Qemalit ishte e shkurtër, pasi për rrethanat e krijuara u detyrua të japë dorëheqjen. Vendi, në vazhdim do të drejtohej nga princ Vidi, i caktuar nga kancelaritë kryesore evropiane, por koha që udhëhoqi, qe shumë e shkurtër se, me fillimin e Luftës së Parë Botërore, ai largohet nga kish ardhur dhe vendi bëhet arenë e pushtimit nga ushtritë ndërluftuese. Kjo situatë do vazhdojë edhe pas mbarimit të luftës, por deri në vitin 1920, Shqipëria do të drejtohej nga qeveri të përkohshme dhe komandat e trupave pushtuese fituese të luftës. Kongresi i Lushnjës i mbledhur më 21-31 janar 1920, mori vendime shumë të rëndësishme si: rikonfirmoi me një akt kushtetues Pavarësinë e plotë të Shqipërisë, zgjodhi Këshillin e Lartë prej 4 vetash dhe Këshillin Kombëtar me 37 veta, Kryeministër u zgjodh Sulejman Delvina. Votoi unanimisht rrëzimin e qeverisë së Durrësit dhe caktoi kryeqytet Tiranën e të tjera.

Në qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës nuk përfshihej Ministria e Luftës, por shpejt lindi nevoja e krijimit të saj dhe të ushtrisë shqiptare. Në mbledhjen e Senatit të datës 30 tetor 1920, u lexua një letër e Kryeministrit, që mban datën 26 tetor 1920, nëpërmjet së cilës shpallte pëlqimin për “formimit të një Ministrie të Luftës”. Po atë ditë, u lexua dhe një letër e senatorit, patriotit e poetit shkodran Hil Mosi, që ndërmjet të tjerave shtronte nevojën e krijimit të ushtrisë shqiptare dhe të Ministrisë së Luftës, sepse “ushtria është ajo fuqi, që siguron gjallërinë e shtetit”. Edhe gazeta “Besa Shqiptare”, që botohej në Shkodër, në një artikull të datës 10 qershor 1920, shkruante, se “Për me përba Shqypninë me e majtë duhet një Qeveri, duhet një xhandarmëri, duhet Ushtri”.







Regjimenti 2 i Artilerisë “18 Tetori”, fotografi e bërë në ditën e marrjes së flamurit luftarak (1947)

Me krijimin e Ministrisë të Luftës, ministër u emërua Ali Riza Kolonja, Kryetari i Shtatmadhorisë u caktua major Ali Shefqeti (Shkupi).

Ushtria shqiptare u organizua mbi bazën e tre regjimenteve ushtarake. Më 5 dhjetor 1920, u emëruan komandantët e regjimenteve dhe u caktuan vend-dislokimet e tyre dhe të batalioneve që kishin në përbërje. Me fillimin e funksionimit të regjimenteve, në muajin janar 1921, ato u kompletuan dhe me 1-2 bateri artilerie, prandaj data 17 janar 1921, me vendim të posaçëm është caktuar data e artilerisë të ushtrisë Shqiptare. Rrugëtimi i saj, në një ushtri të re të sapoformuar të një vendi të varfër me financa e buxhete të kufizuar ka qenë i vështirë, me përpjekje e sakrifica të mëdha, për t’i kaluar si për personelin, i cili vinte nga shërbimi në ushtritë e huaja, ashtu dhe pajisjet që ishin ato të ushtrive pushtuese të mbetura me largimin e tyre. Në varësi të situatave politike, situatave në rajon e marrëdhëniet me fqinjët si dhe të gjendjes ekonomike-financiare do të ecte dhe gjendja në ushtri. Me largimin e qeverisë së Fan Nolit, në vitin 1925, Shqipëria shpallet Republikë me president A. Zogu dhe më 1 shtator 1928, me miratimin e statutit të ri, zë fill monarkia shqiptare, me Ahmet Zogun mbret, që tregonte një stabilitet politik më të qëndrueshëm. Ushtria si fillim do të riorganizohet në vitin 1925, ku do të përfshihej edhe artileria. Në organikën e saj do të përfshiheshin edhe 4 oficerë italianë, të cilët erdhën si instruktorë për bateritë e artilerisë, që ishin blerë në Itali. Në muajin nëntor të vitit 1929 u dekretua “Ligji mbi organizimin e fuqive armate”. Artileria përfshihej në “Forcat Tokësore”, me emërtim “arma e artilerisë”, ku renditeshin: 1 komandë artilerie; 4 komanda grupi artilerie, me nga 3 bateri secili, artilerinë e regjimenteve. Gjendja organike me oficerë ishte 5 nënkolonelë, 6 majorë, 44 kapitenë të klasit të parë e të dytë, 27 togerë, 39 nëntogerë, gjithsej 121 oficerë. Rregullime u bënë edhe në vitin 1931 dhe në vijim, ku parashikohej rritja e numrit të oficerëve deri në 200 veta si dhe futja në përdorim e artilerisë me tërheqje mekanike e përmasave të tjera organizative. Një nga problemet kryesore, është përballuar me ngritjen e artilerisë ka qenë përgatitja e kualifikimi i personelit të saj. Faktikisht, që përpara ngritjes së ushtrisë shqiptare, në vitet 1920 kishte oficerë shqiptarë të diplomuar në shkollat e artilerisë jashtë vendit. Në vitin 1926, për nevoja të artilerisë u hap një kurs 1 vjeçar, i cili përfundoi në muajin janar 1927, në të cilin u përgatitën 6 aspirantëartiljerë. Me ngritjen e ushtrisë, po vinte në shtim numri i trupës së artilerisë, e cila po organizohej në formacione më të mëdha se bateria, grup artilerie, kushtëzoi hapjen në Tiranë të shkollës për aspirantë me profil artilerinë me 20 studentë. Këta vinin nga maturat e gjimnazeve, ose të shkollës teknike. Më 15 tetor 1928, u përruaa shkolla e artilerisë. Krahas kësaj, përparësi iu dha arsimimit ushtarak jashtë vendi, kryesisht në Itali. Përgatitja e këmbësoreve,artiljerëve e xhenierëve për nivelin deri në batalion bëhej në shkollat qendrore, në qytetin e Civitovenchei. Oficerë, për nivele më të larta ndiqnin akademinë e artilerisë e të xhenios, në Torino. Prezenca e oficerëve italianë ishte evidente në të gjithë repartet e artilerisë dhe shkollat e nënoficerëve të artilerisë (viti 1927). Në kurse të ndryshme disa mujore janë përgatitur oficerë plotësues (rezervistë) të artilerisë, që merreshin nga të rinjtë me diplomë të shkollës së mesme (kjo vazhdoi edhe pas bashkimit të ushtrive me pushtimin fashist të vendit). Edhe për përgatitjen e nënoficerëve e të trupës së artilerisë ekzistonin shkolla e qendra të veçanta. Për trupën funksiononin qendrat e instruksionit të artilerisë në Shkodër dhe Elbasan. Për të plotësuar nevojat për literaturë, në Shtabin Madhor u krijua dega e përkthimeve. Në këtë degë ka punuar si përkthyes për artilerinë muzikanti e këngëtari popullor i përmendur shkodran Kole Gurashi.

Duke pasur parasysh vështirësitë që kishte përgatitja e ushtarëve të artilerisë, shërbimi ushtarak aktiv nga 6 muaj u bë 12 muaj, ndërsa më vonë u zgjat në 18 e deri në 24 muaj. Për të përcaktuar nivelin e shkallës së përgatitjes e të gatishmërisë së artilerisë, që në vitin 1925 u fut inspektimi i trupave të artilerisë, në Tiranë. Në strukturën organizative artileria ka ardhur duke u perfeksionuar. Në fillim ajo është në regjiment (grup), ndërsa më vonë lindi nevoja për përfshirjen e saj në batalionin e këmbësorisë. Me rritjen e buxhetit për Forcat e Armatosura u mundësua blerja e armëve të artilerisë dhe formimin e grupit të artilerisë, dhe në strukturën e shtabeve vendoset oficeri për artilerinë. Në vitin 1930, në shtabin e regjimentit u vendos dhe komandanti i artilerisë. Arritje e madhe është krijimi i Komandës së Artilerisë Tokësore, që ishte në vartësi të Komandantit të Përgjithshëm të FA-së, që krijoi mundësi më të mëdha, për rritjen e fuqizimin e artilerisë, përgatitjen e personelit, përdorimin luftarak e të zjarrit të artilerisë me efikasitet, në interes të reparteve të këmbësorisë. Krijimi i komandës në nivel regjimenti dhe shtabit madhor jepte mundësinë e përdorimit të artilerisë e zjarrit të saj në mënyrë të centralizuar. Oficerëtartiljerë dhe arma e artilerisë fituan një reputacion në masën e personelit ushtarak shqiptar të kohës. Oficerët e artilerisë sollën në Shqipëri kulturë e sjellje perëndimore të kohës.

Me gjithë punën e bërë për vite të tëra për ngritjen e armës së artilerisë, kur nevoja për mbrojtjen e vendit nga agresioni fashist italian i 7 Prillit 1939, dhe forcat e tjera të ushtrisë nuk ishin në gjendje të plotësonin detyrën ndaj Atdheut, jo për paaftësi a mosdashje, por për shkaqe politike të brendshme e kapitullues të lidershipit, që nga mbreti Zog e qeveritaret e tij, të cilët braktisën vendin në atë moment dhe sabotimet që kishte bërë misioni italian pranë ushtrisë shqiptare, në të gjithë nivelet e saj. Me pushtimin fashist të vendit u bë dhe bashkimi i ushtrive të të dy vendeve. Në muajin qershor-korrik 1940 u futën në këto forca 4 bateri artilerie 75/13 mm të kompletuara dhe në gatishmëri. Në muajin qershor 1939 u hartua lista e oficerëve shqiptarë e korrektuar nga shënime të shkurtra për secilin nga ata, si dhe e relatuar prej komisionit ushtarak italian në Tiranë, i cili i njihte mirë ata. Kjo listë, ndonëse jo komplet, mungonin 72 oficerë, pothuajse që të gjithëartiljerë. Kuptohet, që mos përfshirja e tyre në ushtrinë italiane bëhej nga implikimi i tyre në lëvizjet politike të kohës si dhe qëndrimin e tyre atdhetar ndaj pushtimit fashist të Shqipërisë. Qëndrimi atdhetar i disa oficerëve shqiptar shfaqet dhe në Itali, ku ato vazhdonin studimet. Disa oficerë shqiptarë u inkuadruan në reparte italiane të dislokuara në Itali dhe mbetën atje. Ndërmjet atyre, që mbeten në Itali, qe dhe majori i artilerisë Llazar Bojaxhiu, vëllai i Nënë Terezës. Në muajin qershor-korrik 1940 u bë inkuadrimi dhe njësitë e përcaktuara të këtyre baterive të kompletuara e në gatishmëri. Si batalionet shqiptare dhe 4 bateritë e artilerisë në njësitë italiane morën pjesë në luftën italo-greke në vitin 1940-1941. Trupat shqiptare në këto luftime mbajtën një qëndrim jo aktiv, duke dezertuar nga fronti prandaj ata, komanda italiane i tërhoqi në thellësi të vendit. Me kapitullimin e Italisë fashiste vendi pushtohet nga nazistët gjermanë. U krijua Këshilli i Naltë i Regjencës, i cili më 5 nëntor 1943 emëroi qeverinë, e cila mori përsipër rikrijimin e ushtrisë shqiptare. Formacioni i organizuar ishte regjimenti. Në regjiment bënte pjesë dhe një bateri shoqërimi 65/17 mm. Në përbërje të ushtrisë shqiptare ishte përfshirë edhe komanda e artilerisë, por organizimi i plotë nuk u arrit të behëj derisa në prag të çlirimit ajo u shpërbë. Agresioni fashist e pushtimi i vendit u prit me urrejtje nga populli e me rezistencë të armatosur, e cila do të vinte duke u shtuar, duke krijuar formacionet e para të armatosura.

Krijimi i frontit Nacionalçlirimtar rriti vullshëm luftën e krahas çetave krijohen batalionet partizane dhe më 10 korrik 1943, krijohet Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me komandant Spiro Moisiun e komisar Enver Hoxhën. Lufta vjen duke u zgjeruar dhe krijohen njëra pas tjetrës brigadat partizane, divizionet dhe korparmatat. Në të gjitha këto formacione, me armët e rrëmbyera okupatorit fashist-nazist krijohen dhe nënrepartet e artilerisë partizane, të cilat bëhen mbështetje për luftimet, që u zhvilluan deri në çlirimin e vendit, më 29 nëntor 1944, por dhe më tej, në ndjekjen e nazistëve dhe matanë kufirit shtetëror. Aksioni simbol i artilerisë së Ushtrisë Nacionalçlirimtare ishte goditja me top nga kodrat e Saukut të pallatit (sot pallati i brigadave), ku do të mblidhej e ashtuquajtura Ansamble Kombëtare. Kjo datë është përkujtuar deri në vitin 1992, si datë e krijimit të Armës së Artilerisë Tokësore të Ushtrisë Popullore Shqiptare. Pas çlirimit të vendit, për ushtrinë shqiptare fillon një epokë e re në organizimin e pajisjen e saj me armatim bashkëkohor. Një vëmendje të madhe do të ketë artileria, e cila do të ketë në përbërjen e saj topat e kalibrit nga 45 – 130 mm, obuzë e top-obuzë 122- 152 mm, mortaja nga 82 – 160 mm, artileri reaktive 107- 130 mm, artileri bregdetare 85-130 mm e të tjera. Numri i përgjithshëm në vitet ’80 i grykave të zjarrit të kalibrit të mesëm e të madh shkonte në 4000 gryka zjarri, ndërsa së bashku me kalibrat më të vegjël, shkonte disa fish më shumë. E gjithë kjo artileri ishte në strukturën e 127 Brigadave të Këmbësorisë e të 22 Divizioneve të Këmbësorisë. Ajo ishte e organizuar në bateri e kompani; në grupe (batalione) artilerie, të cilët përbëheshin nga 2-3 bateri, regjimente me përbërje 3-4 grupe, brigadë artilerie me përbërje 5-6 grupe, regjimenti kundërtank, me përbërje deri 6 bateri të topave kundërtank; regjimente të artilerisë bregdetare, me përbërje 4-6 bateri. Në strukturën e organizative artileria ishte organizuar: Në batalion këmbësorie, një bateri topash pa zmrapsje dhe një kompani mortajash, në Brigadë Këmbësorie 2-3 grupe artilerie e mortaja, 1 grup kundërtank, 1 bateri lartësie, në Korpus-Divizion Këmbësorie, brigade (regjiment) artilerie ose 2-3 grupe artilerie, grup ose regjiment artilerie kundërtank, në bregdet edhe 1 regjiment të artilerisë bregdetare. Për drejtimin e artilerisë funksiononin këto struktura, në batalion- shefi i artilerisë, në brigadë-seksioni i artilerisë, në divizion-dega e artilerisë, në shtabin e përgjithshëm - drejtoria e artilerisë. Një vëmendje e madhe iu kushtua përgatitjes së kuadrit të artilerisë në shkollat tona ushtarake. Pranë Shkollës së Bashkuar përgatiteshin oficerëartiljerë të nivelit bateri e deri në grup. Në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm kualifikoheshin për nivelin e artilerisë së brigadës së këmbësorisë e të divizionit të këmbësorisë dhe brigadë artilerie. Deri në vitet 1960 një pjesë e kuadrit u shkollua dhe kualifikua në shkollat e akademitë sovjetike e më pas të gjithë nevojat plotësoheshin në vend. Shkollimi për kuadro rezervist ishte i organizuar në 3 shkolla ushtarake Zall Herr-Tiranë, Bonavi-Vlorë dhe Vau Dejës-Shkodër, ku studimet zgjatnin 2 vjet e përgatiteshin kuadro për drejtimin toge-bateri (kompani). Pranë divizioneve funksiononin shkollat e oficerëve rezervistë, ku rikualifikoheshin një herë në 5 vjet dhe këto kurse zgjatnin 2 muaj. Përdorimi luftarak i artilerisë dhe zjarrit të saj në luftim u sanksionua në Artin Ushtarak Popullor, në të cilën përcaktohej, se artileria tokësore është fuqia e zjarrit kryesore e forcave tokësore, ajo duhet përqendruar në drejtimet kryesore si në mbrojtje ashtu dhe në mësymje. Zjarri i artilerisë e mortajave së bashku me atë të mitralozave dhe armëve të këmbësorisë i ndërthurur dhe me të gjitha llojet e pengesave xhenierë përbënte bazën e sistemit të zjarrit. Mbrojtja kundërtanke në drejtimet e kalueshme nga tanket e mjetet e tjera të blinduara përbënte bazën e ndërtimit të mbrojtjes dhe ishte e organizuar e qëndrueshme, e thellë e aktive. Bazën e mbrojtjes kundërtanke e përbënte zjarri i artilerisë dhe mjeteve kundërtankeve. Një investim i madh u bë në fortifikimin e artilerisë me pozicione zjarri tip tunel, parafabrikat dhe punime fushore. Përveç pozicioneve kryesore për çdo bateri kishte dhe 1-2 pozicione rezervë. U ndërtuan pikat e drejtimit e vendkomandat si dhe u bë kalbëzimi telefonik në rendimet e luftimit. U realizua shtrirja e rrjetit mbështetës të artilerisë në zonat e veprimit të saj me jo më se një pikë për km². Artileria jonë e gatshme si në drejtimet tokësore, bregdetare dhe në zonat e desantimit ishin në gjendje, që për 15-20 minuta të hapte zjarr. Grupet kompletoheshin për 2-3 orë ndërsa brigadat 5-6 orë me kontingjentet rezerviste. Përgatitja e artilerisë realizohej gjithëvjetorë në të gjitha nivelet e saj dhe aftësitë e saj provoheshin në stërvitje shtabi, komando shtabi, stërvitje me trupa, me qitjet luftarake që përbënin shkallën më të lartë të përgatitjes. Në fund të viteve ’80 artileria filloi të pajisej me makina llogaritëse të programuara për qitjen e drejtimin e zjarrit sipas kalibrave përkatës, largësimatësi me rreze lazer e të tjera, që përbënin një risi për ne. Ndryshimet në sistemin politik e ekonomik të vendit u shoqëruan me ndryshime të thella dhe në fushën e sigurisë e mbrojtjes. Reformat e realizuara mbas viteve ’90 në Forcat e Armatosura sollën ndryshime të rëndësishme, por artileria nga reforma në reformë erdhi duke u zvogëluar në strukturë ashtu dhe në numrin e grykave të zjarrit derisa nga viti 2005 ekziston në mënyrë simbolike në nivel batalioni. Anëtarësimi në NATO ka krijuar mundësinë e modernizimit në sisteme artilerie e raketash bashkëkohorë. Rrugëtimi mbi njëshekullor i artilerisë ka në themel të tij kontributin e brezave të ushtarakëve, të cilët investuan e materializuan krijimin dhe forcimin e saj, u bënë roje e sovranitetit e të paprekshmërisë së Atdheut gjatë luftës së ftohtë e deri në ditët tona.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ,  
(Mjeshtëri i Madh)

# LONI KRISTO, komandant e pedagog në Armën e Tankeve

## Myfit Metani: Ndjesitë e një lideri si Loni Kristo Komandant Loni në vijën e parë të stërvitjes

Loni Kristo u specializua për armën e tankeve në BS. Arma e Tankeve pas formimit të saj, më 1 prill 1946, mori zhvillim si gjithë armët e tjera të Ushtrisë Shqiptare të asaj kohe. Loni Kristo, që në fillim ishte ndër drejtuesit e armës së tankeve. Unë, pasi u titullova ‘oficer’ me gradën ‘nëntoger’, më 31 korrik 1965, u emërova komandant toge në batalionin e tankeve në Uznovë të Beratit, ku komandant ishte Loni Kristo. Të rinjtë në armën e tankeve kishim etje për dije, për t’u bërë kuadro të denjë në drejtim e nënreparteve e reparteve të tankeve. Komandant Loni ishte i aftë nga ana profesionale dhe drejtues e komunikues shembullor. Në mësimet teorike që zhvilloheshin herë pas here me kuadrot për përdorimin e tankeve në llojet e luftimit dëgjoni me vëmendje shpjegimet që bënte komandant Loni të konkretizuara dhe me skema në dërrasën e zezë.

Po tregoj një rast nga puna për ndërtimin e tuneleve për strehimin e teknikës së tankeve. Objektivi ishte dy metër në turn me përmasat për strehimin e tankeve. Kisha gjashtë muaj që drejtoja togën e tankeve. Rezultatet në stërvitje, disiplinë e në punimet për ndërtimin e tunelit për strehimin e tankeve kishin përparësi. Vjen komandant Loni e në një moment ndjek ecurinë e punimeve në turnin ku punoja me togën. Së bashku me ushtarët lëviznim vagonin për të nxjerrë jashtë mbeturinat pas plasjes së minave në thellësi të tunelit. Komandanti pyeti se përherë e bëja këtë punë. I përgjigjet komandanti i kompanisë Gurali Stërgu: “E fillon dhe mbaron punën bashkë me ushtarët e togës së tij”. Nëpërmjet punës me ushtarët komandanti i togës evidentonte dhe problemet gjatë punës. Komandanti theksoi se e kishte informacionin, por po e verifikonte konkretisht. Përgëzoi ushtarët dhe theksoi se i duhen kuadro ushtrisë e armës së tankeve model në të gjitha disiplinat. Shembullin tim e bëri model dhe ua prezanton komandës eprorë, e cila më emëroi komandant kompanie mbas gjashtë muaj si komandant i togës tankiste.

Batalioni i tankeve ishte Rezervë e Komandës së Përgjithshme dhe merrte pjesë në shumë stërvitje që organizonte çdo vit Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë. Komandant Loni Kristo si parashikues e largpamës bënte parapërgatitjen me kuadrot dhe efektivin në bazë të një plani paraprak. E fillonte stërvitjen me marshim, me parashikim luftimi ndeshës. Leksionet teorike i konkretizonte me skema në dërrasën e zezë nga marshimet e kryera me nënrepartet e repartet që kish komanduar. Në vijim vazhdonte me leksionet për luftimin kundër desantit ajror, luftimin mësymës e luftimin mbrojtës. Shtronte detyrën që në stërvitjet me efektivin të trajtoheshin e praktikoheshin marshimet, luftimi mësymës e mbrojtës. Kjo metodë pune e komandant Lonit ishte një shkollë e madhe. Në radhë të parë, na aftësonte për artin taktik, që t’i përfytyronim sa më saktë kriteret e përdorimit të tankeve në llojet e luftimit dhe të na mbante në gatishmëri e të përgatitur për çdo situatë e në çdo kohë të realizonim detyrën që na jepej.

Në tetor 1967, batalioni i tankeve me 31 tanke me komandant batalioni Loni Kristo lëvizi në rrugëkalimin Poshnje e Beratit - Ura e Kuçit - kisha e Ardenicës dhe u përqendrua në kodrat e Ardenicës në gatishmëri të detyrës për luftimin kundër desantit ajror në fushën e Libofshës. Në atë kohë isha komandant i kompanisë së tretë me 10 tanke të batalionit të tankeve. Në orën 04.00 të mëngjesit pas zënies së vijës së hapjes në kodrat e Ardenicës, batalioni me 31 tanke u hodh në sulm për asgjësimin e desantit ajror (të imituar) në fushën e Libofshës. Mësymjen e suksesshme të tankeve e ndiqte me helikopter nga ajri shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Petrit Dume. Për të verifikuar ndërlidhjen brenda për brenda tankeve e midis tankeve me këmbësorinë, AT, AKA, xhenion, kiminë, organet e prapavijës etj., ai urdhëroi ndryshimin e drejtimi



Loni Kristo komandant e pedagog

të mësymjes të batalionit të tankeve. Në një situatë të tillë në fushë të hapur me objekte të kufizuara orientimi, sidomos për tanket, komandant Loni ishte një mjeshtër i taktikës së tankeve e gjeti zgjidhjen argumentuese të menjëhershme. Në komunikim me shtabin saktësoi në mënyrë precize ndryshimin e drejtimi të mësymjes të kompanisë që drejtonte Myfit Metani. U saktësua drejtimi i mësymjes së togave tankiste e të tankeve dhe u urdhërua veprim i menjëhershëm i mësymjes në drejtimin e ndryshuar. Këto veprime u kryen dhe në dy kompanitë e tjera. Në mënyrë të shpejtë të 31

tanket e batalionit bënë ndryshimin e saktë të drejtimi të veprimeve dhe vazhduan mësymjen e mëtejshme të suksesshme. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Petrit Dume ndoqi me vëmendje veprimet e sakta për ndryshimin e drejtimi dhe mësymjen vijuese, si dhe falënderoi komandën e batalionit, kuadrot dhe efektivin për realizimin me sukses të detyrës luftarake. Myfit Metani kujton detyrat e sakta e precize, që jepte komandant Loni Kristo në stërvitjen taktike konkrete, si në një luftë të vërtetë. Stërvitjet ishin shkolla praktike për konkretizimin në terren të artit taktik të parimeve të përdorimit





të tankeve në llojet e luftimit.

**Në degën operative të komandës së tankeve dhe pedagog**  
Në vijim, pas viteve 1965 arma e tankeve mori zhvillim të përmasave të mëdha. U krijuan njëra pas tjetrës Brigada Tankesh (BrT) në Shkodër, Laç, Zall-Herr e Sauk të Tiranës, Vorë, Kavajë, Elbasan, Korçë, Berat, Gjirokastrë dhe 6 batalione tankesh në afërsi të kufirit, në drejtimet më të rëndësishme të përdorimit të tyre. Moria e detyrave imponoi kalimin e degës së tankeve në komandë të tankeve dhe mjeteve të blinduara me komandant Abaz Fejzo.

Loni Kristo u emërua drejtor operativ i komandës së tankeve dhe mjeteve të blinduara. Në këtë detyrë shfaqí aftësi profesionale dhe saktësoi në mënyrë shkencore, rajonet e përqendrimit të çdo BrT në vendvendosje, detyrat luftarake të secilës prej tyre të ballafaquara me stërvitje me tanke në terren e detyra të tjera. Pedagog Loni ishte konkret në saktësimin e detyrave, sidomos për ato, që lidheshin me vendvendosjen e përhershme të njësive tankiste të sapo formuara e për detyrat e menjëhershme, që mund të zgjidhnin qysh në momentet e para. Së pari organizoi një mësim tregues me shefat e shtabeve të njësive tankiste të ushtrisë dhe konkretisht në BrT të Korçës, ku Myfit Metani ishte shefi i shtabit të brigadës, ndërsa me BrT të Shkodrës u saktësuan rajonet e përqendrimit të reparteve e të njësitë tankiste e kohën e afrimit në marrjen e sinjalit të kushtrimit për detyrën luftarake.

Me dhënien e sinjalit të kushtrimit, pjesëmarrësit ndoqën afrimin

e nënreparteve e reparteve të njësisë tankiste për në detyrën luftarake. Dy reparte mbërritën në kohë në vijën e hapjes, ndërsa i treti më vonë. Nga analiza doli se rajoni i përkohshëm i përqendrimit ishte në një distancë të atillë, që shpejtësia optimale e tankeve nuk e realizonte atë në kohën e parashikuar. U bë afrimi i rajonit të përqendrimit dhe u ndoqën veprimet e repartit për te detyra luftarake, të cilën e realizoi në kohë. Ndërhyrja e Loni Kristos, bëri që rajoni i ri i përqendrimit të kapej në kohë nga reparti. Këtë metodë pune zbatoi për të saktësuar rajonet e përhershme të përqendrimit të reparteve e të njësive tankiste për në vijat e hapjes për detyrën luftarake. Kështu u fitua eksperiencë nga puna e tankistit të njohur, komandantit e pedagogut Loni Kristo.

Në shtator 1971, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes u hap kursi për tanke në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm. Vendimi ishte i duhur dhe nëpërmjet kursit akademistët tankistë konsoliduan aftësitë për artin e drejtimit të tankeve në luftë. Merita për të i dedikohet komandës së Tankeve me Abas Fejzon. Në krye të katedrës së tankeve u emërua Loni Kristo, njeriu i duhur. Moria e metodikave për t’u përpiluar nga grupet e punës në mënyrë argumentuese e shkencore, kriteret e përdorimit të tankeve në mësymje, mbrojtje, në luftimin kundër desantit ajror, në marshim me parashikim luftimi ndeshës etj., e donin një drejtues të tillë. Në vijim u krijuan materialet e nevojshme për zhvillimin cilësor të mësimi. Në kursin e parë ishte dhe Myfit Metani me 15 akademistët e parë. Akademistët



ndoqën me kënaqësi mësimin nga Loni Kristo me temë: “Brigada e tankeve në mësymje në bashkëveprim me këmbësorinë, AT, AKA, xhenion, kiminë, prapavijën etj. Shpjegimi nga ana e pedagog Lonit me argumente u krijoi mundësi akademistëve për përfytyrim të saktë e me kompetencë të veprimeve mësymëse të tankeve në terrenin e luftimeve në bashkëveprim me llojet e tjera të armëve. Kështu u saktësua në mënyrë graduale mendimi në procesin mësimor për rolin e tankeve në fushën e luftimit, kur tanket shfrytëzoheshin me efikasitet. Në vazhdim të kursit, akademistët e kërkonim herë pas here Loni Kriston për sqarimin e argumentimin më të thelluar të problemeve të veçanta në artin taktik të përdorimit të tankeve në llojet e luftimit. Gjatë kursit për tanke në Akademi ndoqëm mësimet nga pedagogë të afirmuar tankist si Loni Kristo, Dino Brati, Vangjo Monosopi etj., duke u përgatitur më të aftë për përdorimin e tankeve në llojet e luftimit.

**Kuadrot tankistë fituan nga përvoja e komandantit**  
Kështu pas mbarimit të Akademisë tankistët konkurronin si të barabartë me këmbësorët, artiljerët tokësorë e kundërajror, xhenierët, kimistët etj. Në saje të Akademisë evitua me kompetencë ndërhyrjet e këmbësorëve për përdorimin taktik të tankeve në terren. Me mbarimin e kursit për tanke Myfit Metani u emërua shef i Shtabit të BrT në Korçë. Detyra e parë ishte planifikimi i përdorimit të tankeve në llojet e luftimit në kuadër të Divizionit të Këmbësorisë të Korçës. Kështu, gjatë një stërvitjeje u ndryshua mendimi i komandës eprorë në përdorimin e tankeve në mësymje në drejtim të Qafës së Qarrit për në Ersekë nga krahu i majtë ku s’kalonte as dhia, në drejtimin e djathtë. U paraqit plani para shefit të Shtabit të DK të Korçës për përdorimin e tankeve dhe u planëzuan në terrenin e kalueshëm të përdorimit të tyre. Me krijimin e batalionit të specialiteteve në Akademinë ushtarake “Skënderbej”, Loni Kristo u emërua shef i Fakultetit Tanke-Autotraktorë, ku pedagogët e taktikës në katedrën e tankeve e pritëm me kënaqësi ardhjen e tij në detyrë. Realizimi i mjaft detyrave e funksioneve që nga nënreparti, reparti, njësia tankiste, drejtor operativ në komandën e tankeve e mjeteve të blinduar, shef i katedrës së tankeve në ASHP, e së fundi shef i fakultetit tanke-autotraktorë, ishin dëshmia e një eksperience të madhe të fituar nga Loni Kristo. Pjesëmarrja dhe drejtimi i stërvitjeve të shkallëve të ndryshme me tanke në terren të Loni Kristos rritën në shkallën më të lartë përfytyrimin e forcën argumentuese për artin taktik të përdorimit të tankeve në llojet e luftimit. Në çdo kohë ishte i gatshëm të jepte përvojën dhe eksperiencën e tij me kuadrot dhe efektivat tankiste të ushtrisë. Njeri prej tyre, Myfit Metani ka mësuar shumë nga eksperiencia e forca argumentuese, që i bënte pedagog Loni artit taktik të përdorimit të tankeve në llojet e luftimit.

Në tetor 1967 Myfit Metani u emërua pedagog i taktikës së tankeve në AU “Skënderbej”, ku eksperiencia teorike dhe praktike nuk i mungonin. Taktika është art, është mjeshhtëria e të vepruarit e të luftuarit në fushën e luftimit. Por për të luftuar e fituar në luftë duhet të kesh njohuri të thella teorike të kombinuara me përgatitje të vazhdueshme të stërvitjeve në terren. Që studentët të krijojnë një përfytyrim më të qartë për konceptet teorike, u ndërtova një kabinet me skema të nënreparteve, reparteve e njësive tankiste në llojet e luftimit dhe një maket terreni, ku konkretizojta pjesë të veçanta të anës teorike, që studenti ta përfytyronte e ta kishte më të lehtë ta konkretizonte në terrenin ku zhvillohej rikonicioni, bashkëveprimi e drejtimi i luftimi.

Për ndërtimin e kabinetit e maketin të terrenit u konsultova me shef Loni Kriston. Ai e përkrahu shumë nismën. Erdhi në mbledhjen e katedrës ku u diskutua ndërtimi i kabinetit të taktikës. Ndërtimi i maketit të terrenit nga pedagog Myfit Metani ishte një nismë që u përshëndet dhe u përkrah nga shef Loni. Gjatë shpjegimit të koncepteve teorike, pjesë të elementëve të veçantë si rajoni përqendrimit, rrugët e afrimit për mësymje, vija e hapjes, fushat e minuara, objekti i sulmit, drejtimi i mëtejshëm i sulmit etj., u konkretizuan dhe në maket. Studentët i fiksojnë ato e bëjnë përfytyrimin, si e ku janë këto elemente dhe në terren e kanë më të lehtë të organizojnë rikonicionin, bashkëveprimin e drejtimin e luftimit. Nisma gjeti përkrahjen e kolegëve, por pati edhe nga ata, që ngritën probleme. Loni Kristo mbështeti mendimin e shfaqur për të ngritur kabinetin, si dhe kontribui për ndërtimin e tij, për t’u bërë sa më shpejt e të vihej në funksion të studentëve. Gjatë ndërtimit të maketit të terrenit shef Loni Kristo vinte shpesh, shkëmbente mendime për ndërtimin e pjesëve të veçanta të tij. Kabineti u ndërtua e u vu në funksion të studentëve. Falënderimet për të nuk munguan nga studentët dhe kuadrot e njësive dhe reparteve tankiste. Në ndërtimin e kabinetit të taktikës së tankeve pedagog Loni Kristo dha si kudo ndihmesën e tij të vlefshme. Për kontributin e komandantit e pedagogut të njohur të tankeve lind nevoja të shkruash pambarimisht...



# TERRORI NUK DUHET TË LUFTOHET ME TERROR

## Çfarë mund të mësojë Izraeli nga SHBA-të, në luftën kundër terrorizmit



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Më 15 janar 2025, u arrit një armëpushim i shumëpritur ndërmjet Hamas dhe Izraelit. Kjo marrëveshje u deklarua nga presidentët amerikanë, Biden në largim dhe Trump, i cili do të marrë Shtëpinë e Bardhë më 20 janar. Kjo jo vetëm të fuqisë që SHBA-të posedojnë por edhe për faktin se lufta kundër terrorizmit është një çështje që ka shqetësuar Shtetet e Bashkuara prej më shumë se 20 vite, nga e cila sigurisht ka marrë dhe mësim. Nga analiza e fenomenit, del se ka ngjashmëri të dukshme midis përgjigjes së Izraelit ndaj sulmeve të Hamasit të 7 tetorit 2023, dhe përgjigjes së SHBA-ve ndaj 11 shtatorit 2001. Në të dy skenarët, udhëheqja nën presion të madh publik për t'iu përgjigjur me forcë ushtarake ndaj sulmeve, çoi në vendosjen e fuqisë luftarake përpara se të ishin përcaktuar objektiva të qarta ushtarake. Rrjedhimisht, objektivat është dashur të ndryshojnë përgjatë luftës për t'iu përshtatur situatës në terren.

Izraeli është një shtet i vogël me burime të kufizuara njerëzore dhe financiare, për ta pushtuar dhe më vonë e rindërtuar e vetme Gazën. Është e domosdoshme për interesat dhe stabilitetin rajonal që Izraeli të vendosë objektiva të arritshme dhe t'i përmbushë ato sa më shpejt të jetë e mundur. Nëse kjo nuk ndodh, përparimi i bërë në normalizimin e marrëdhënieve diplomatike të Izraelit me fqinjët e tij arabë gjatë viteve të fundit do të jetë gjithnjë e më i vështirë, për t'u rikuperuar dhe rivendosur. Më 7 tetor 2023, pasi efekti, pasojat dhe qëllimi i sulmit të Hamasit u bë i qartë, kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu doli drejtpërdrejt në TV kombëtar rreth orës 11:00 para Forcave të Mbrojtjes izraelite (IDF) dhe shpalli: "Qytetarë të Izraelit, ne jemi në luftë. Unë do të nis një mobilizim të gjerë të rezervave tona kombëtare për të luftuar në një shkallë dhe intensitet të tillë, që armiku nuk e ka përjetuar deri më tani. Hamas do të paguajë një çmim të paparë. Jemi në luftë dhe do të fitojmë". Qëllimi i Netanyahu për të përcjellë revoltën dhe ndjesinë e momentit si dhe për t'i treguar botës se qeveria e tij ishte e përgatitur të përdorte forcën e IDF-së, ishte e kuptueshme. 7 tetori ishte kthyer në 11 shtatorin e Izraelit, pasi edhe fjalimi i Netanyahu iu referua pikërisht fjalimit të Presidentit Xhorxh W. Bush drejtuar kombit në atë ditë fatale për SHBA-të. Presidenti kapi gjendjen shpirtërore të vendit duke deklaruar: "Sot, bashkëqytetarët tanë, mënyra jonë e jetesës, vetë liria jonë u sulmuan në një sërë aktesh terroriste të qëllimshme dhe vdekjeprurëse. Ushtria jonë është e fuqishme dhe shumë mirë e përgatitur."

Si Izraeli ashtu edhe Shtetet e Bashkuara ishin sulmuar në një mënyrë që askush nuk e kishte imagjinuar deri në atë moment. Të dy vendet, ishin goditur nga terrorizmi në të kaluarën, por aktualisht ndiheshin të sigurt se armiqet e tyre ishin të mposhtur dhe të paafte për të ndërmarrë sulme spektakolare si të 9/11. Të dy popujt dhe qeveritë donin hakmarrje sa më shpejt të ishte e mundur dhe u përpoqën ta arrinin atë duke përdorur ushtritë e tyre të trajnuara dhe të pajisura mirë. Shtetet e Bashkuara e vazhduan luftën e tyre globale kundër terrorizmit për 20 vitet pas 11 shtatorit 2001, por e gjetën veten të mbërthyer në një "moçal" pa rrugëdalje të qartë. Shtetet e Bashkuara ishin në gjendje ta mbështesnin luftën gjatë një periudhe kaq të zgjatur për shkak të burimeve të mëdha financiare



dhe më e rëndësishmja, falë ushtrisë së saj profesioniste dhe tërësisht vullnetare. Izraeli nuk e ka këtë luks, pasi është vend i vogël me GDP prej 539 miliardë dollarë përkundërt SHBA prej 28 trilionë dollarë në 2023, me popullsi prej pak më pak se 10 milionë, krahasuar me popullsinë e SHBA-së prej 337 milionë. Izraeli gjithashtu ka politikë të rekrutimit të shërbimit të detyrueshëm kombëtar, me 40 për qind të burrave dhe 33 për qind të grave, të cilët shërbejnë në detyrë aktive. Këto forca nuk janë, jo vetëm në numër, por edhe cilësisht, të krahasueshme me forcat profesioniste amerikane. Duke pasur parasysh këto kufizime, Izraeli do të ishte mirë t'u kushtonte vëmendje leksioneve që mësuhan Shtetet e Bashkuara në Luftën Globale kundër Terrorizmit.

Lidershipi politiko-ushtarak duhet të parashikojë saktë fundin e luftës. Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanjahu, ish-ministri i Mbrojtjes, Joav Galant dhe lideri i Hamasit, Mohamed Deif, do të përballen me drejtësinë ndërkombëtare për krime lufte. Urdhër arrestet për zyrtarët u lëshuan, më 21 nëntor 2024, nga Gjykata Penale Ndërkombëtare (GJPN) me kërkesë të kryeprokurorit Karim Kan. Vendimi nënkupton që të tre personat rrezikojnë arrestimin në 120 shtete që kanë nënshkruar statutin e Romës të 1998-ës. Mbi 45 mijë persona në Gazë deri në këtë fund viti të 2024, ku operon Hamasi, kanë gjetur vdekjen nga operacionet e ushtrisë izraelite për hakmarrje, por edhe për "shfarosjen" e grupit palestinez që mori përsipër sulmin fillestar. GJPN-ja ka lëshuar më parë edhe një urdhër arrest ndërkombëtar për presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, i cili po ashtu akuzohet për krime lufte në Ukrainë.

Ka patur një presion të madh publik mbi udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara pas 11 shtatorit 2001, po kështu dhe Izraelit pas 10 shtatorit 2023, për të bërë diçka, por saktësisht se çfarë nuk ishte menjëherë e qartë. Administrata e Bushit mori vendim jo vetëm për të shkatërruar Al Kaedën, por edhe për të zëvendësuar regjimin e talebanëve me një regjim demokratik. Njëzet vjet luftë, mijëra jetë të humbura dhe qindra miliarda dollarë të shpenzuara, u bë i qartë se vendimi për ndërtimin e Afganistanit ishte i gabuar. Shtetet e Bashkuara kishin menduar gabim se mund ta shkatërronin regjimin taleban dhe liderët dhe

partitë e reja afgane, do të ishin në gjendje të mbanin pushtetin pa mbështetje të madhe të SHBA-së. Megjithatë, muajt e fundit të vitit 2024 dhe fillim i 2025 kanë treguar se shkatërrimi total i Hamasit kërkon shkatërrimin total të pjesës më të madhe të infrastrukturës të Rripit të Gazës. Hamasi është përgatitur për një luftë të gjatë në Gaza, pasi ka grumbulluar armë, raketa, ushqime dhe furnizime mjekësore në labirintin e tij të tuneleve nëntokësore. Bota e ka parë sesi Izraeli po e nënshtron Gazën, në pamundësi për të kursyer infrastrukturën civile si shkollat dhe spitalet për shkak të pranisë ose afërsisë së luftëtarëve të Hamasit dhe topografisë së dendur urbane të Gazës. Me gjithë këto vdekje dhe shkatërrim që po ndodh në sy të botës, pyetja është sa afër është Izraeli për të përmbushur objektivin e tij fillestar për të shkatërruar Hamasin. Shtetet e Bashkuara mësuhan në Afganistan dhe Irak, se fushatat ushtarake për të zhdukur lëvizjet politiko-ushtarake të rrënjësura shumë thellë në mënyrën e jetesës së tyre, zakonisht dështojnë. Kjo vlen pikërisht edhe për Hamasin, pasi ai i ka rrënjën të shtrira shumë përtej Gazës.

Lufta me armë zjarri duhet të mbështetet me "fuqi të butë" me qëllim që të fitojë zemrat e palestinezëve. Shtetet e Bashkuara zbuluan në rrugën e vështirë në Afganistan dhe Irak, se suksesi fillestar ushtarak shpesh i hap rrugën një fushate të gjatë dhe frustruese kundër kryengritjes. Kjo zgjati për tre vitet e para të operacionit "Liria e Irakut", me operacionet për të shkatërruar grupe të ndryshme kryengritëse. Në vitin 2006, gjenerali David Petraeus filloi një fushatë të re politike-ushtarake të quajtur "Spastro, Mbro dhe Ndërto" për operacionet në Irak. Në këtë qasje të modifikuar ai pranoi nevojën për të ofruar infrastrukturë dhe shërbime për popullsinë, pasi kryengritësit të ishin "pastruar" nga një zonë e caktuar operacionale.

Pasi të largohet vëmendja, dilema dhe dyshimi nga fushata ushtarake e Izraelit, Gazanët pritet të përballen me shkatërrim të paparë dhe me perspektiva më të zymta për të ardhmen, se sa më parë. Nëse Izraeli dëshiron që Hamas të mos kërcënojë kurrë më sigurinë e Izraelit në të ardhmen, ai duhet të pastrojë, të mbajë dhe të ndërtojë infrastrukturën në Gaza. Kjo nënkupton krijimin e kushteve për të lehtësuar vuajtjet, për të ndërtuar





banesa dhe për të rivendosur mjetet e jetesës. Një plan masiv rindërtimi i pasluftës po merr formë për Gazën që do të investohen 3 miliardë dollarë në vit për 10 vjet. Plani që do të rindëronte infrastrukturën e Gazës, do të bashkonte Gazën dhe Bregun Perëndimor nën qeverisjen e Autoritetit Palestinez si dhe do të reformonte forcat e veta palestineze të sigurisë.

Nëse Izraeli nuk ndërhyr në ndërtojë dhe të ofrohet me “fuqi të butë”, banorët e Gazës do të detyrohen të jetojnë në varfëri të pashpresë që me siguri do të ringjallin Hamasin ose diçka të ngjashme me të. Nëse plani i rindërtimit do të financohej nga komuniteti ndërkombëtar, me shumë mundësi Izraelit do t’i duhej të vendoste një forcë paqeruajtëse për të ofruar siguri, si dhe të bënte vetë pjesën më të madhe të punës së rindërtimit. Mbështetja me fuqi të butë do të jetë faktor në bindjen e popullsisë për të drejtën e luftës kundër Hamas dhe jo në rritjen e kundërshtarëve. Ky nuk është problem ushtarak, por socio-ekonomik që rrjedh nga pasojat e konfliktit.

Fillimi i vitit 2025 e gjeti Izraelin në luftë me shumë fronte, e cila do të ketë më shumë kosto, njerëzore, financiare dhe politike ndërkombëtare. Përveç Hamasit, Izraeli është i përfshirë në luftë kundër Iranit, kundër Hezbollah në Liban, në Jemen kundër Houthi dhe së fundmi në dhjetor 2024 edhe kundër instalimeve ushtarake të këtyre grupeve në Siri. Nga ana e tyre Shtetet e Bashkuara kishin mbështetjen e NATO-s dhe komunitetit më të gjerë ndërkombëtar për të shkuar në luftë në Afganistan, ndërsa Iraku ishte përpjekje e njëanshme. SHBA-ja gjithashtu besonte gabimisht se komuniteti ndërkombëtar do kontribuonte në rindërtimin e Irakut. Asgjë nga këto nuk ndodhi dhe Shtetet e Bashkuara pësuan një goditje lidhur me besueshmërinë dhe imazhin e saj ndërkombëtar.

Është e domosdoshme që Izraeli të vazhdojë në rrugën e normalizimit të plotë me shtetet arabe pas luftës me Hamasin, Hezbollah dhe Houthi në mënyrë që, Izraeli mos “të jetë i vetëm”. Sa më i gjatë dhe më i përgjakshëm të jetë pushtimi i Gazës nga Izraeli, aq më i madh do të jetë çmimi që Izraeli do të duhet të paguajë për të rikthyer normalizimin në rrugën e duhur. Tani, Izraeli do të duhet të demonstrojë një angazhim shumë më të madh ndaj zgjidhjes me dy shtete. Miqësia e saj e gjatë me Shtetet e Bashkuara, ndonëse ende e palëkundur në nivel qeveritar, ka shfaqur shenja krisje në opinionin publik amerikan prej disa kohësh. Sondazhi i “Gallup” për mbështetjen izraelite, zbulon se 42 për qind që simpatizojnë më shumë palestinezët dhe 40 për qind me izraelitët. Edhe mes të krishterëve ungjillorë, mbështetja për Izraelin po bie nga 69 për qind në 33 për qind. Është e qartë

se Izraeli i shpërfill këto prirje por shpejt do të përballet me një sfidë të ngjashme që do të reflektohet sigurisht në Gaza.

Ushtria amerikane zbuloi mënyrën e vështirë që shpërndarja e fuqisë luftarake në teatro të shumtë në të njëjtën kohë rezultoi në një rotacion të padurueshëm vendosjeje për trupat e saj. Përveç shqetësimeve të fuqisë njerëzore, rezervat e municioneve në mbarë botën kanë qenë jashtëzakonisht të ulëta vitin e kaluar. Shtetet e Bashkuara kanë rifurnizuar Ukrainën me donacione të mëdha (mbi dy milionë) predha artilerie 155 mm dhe municione të mbrojtjes ajrore. Shtetet e Bashkuara kanë më shumë se dyfishuar prodhimin e këtyre predhave, duke shkuar nga 12,000 në muaj para pushtimit të Rusisë, në 28,000 aktuale në muaj. Megjithatë Shtetet e Bashkuara kanë filluar të devijojnë furnizimet me municion nga Ukraina në Izrael, hapja e fronti kundër Hezbollahut, Huthit dhe të tjerëve në Siri do të kërkonte një kërkesë edhe më të madhe për furnizimet e SHBA-së. Kongresi tani vë në pikëpyetje mbështetjen e vazhdueshme ushtarake të pakushtëzuar për Ukrainën, nuk ka asnjë garanci që furnizimi i Izraelit do të bëhet objektivi i një shqyrtimi nën administratën Trump pas 20 janarit.

Natyrisht, Hamasi dhe Hezbollahu kanë rrënjë të ndryshme. Hezbollahu është një proxy iranian që e merr fuqinë e tij nga popullata shiite, ndërsa Hamasi është një rrjedhë e Vëllazërisë Myslimane dhe mbështetjen nga palestinezët, të cilët janë kryesisht sunitë. Megjithatë, të dy grupet kanë kauzë të përbashkët kundër Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara. Ata e konsiderojnë veten “Boshti i Rezistencës”. Lufta kundër Hezbollahut pati mundësinë për të tërhequr Iranin në konflikt, por pas rënies së Bashar Asad në Siri, në fillim të dhjetorit 2024, Irani është dobësuar më shumë, gjë që e ul mundësinë për kalimin nga një konflikt rajonal në një konflikt global. Rrjeti i aleancave që lidh Izraelin me Perëndimin, si dhe Hamasin dhe Hezbollahun me Iranin dhe Rusinë mund të përshkallëzohet, në një skenar të ngjashëm me aleancat evropiane, që ndezën Luftën e Parë Botërore.

Kujdes nga krijimi i pasojave të padëshiruara. Shtetet e Bashkuara hynë në luftë në Irak për të rrëzuar Saddam Huseinin, por përfunduan duke shkaktuar një luftë civile sektare. Në kohën kur përfundoi operacioni “Liria e Irakut” në vitin 2011, Iraku mbeti me një qeveri të dobët qendrore, një ekonomi të shkatërruar dhe një ushtri që u shkërmoq kur forcat e ISIS pushtuan një pjesë të madhe të vendit vetëm disa vjet më vonë. Që atëherë Irani ka luajtur rol të rëndësishëm në sulmet ndaj trupave amerikane në Irak, në Luftën Civile Siriane, si dhe në armatosjen, financimin dhe trajnimin e Hezbollahut libanez dhe rebelëve Houthi në Jemen. Ata

kanë qenë objektivi i sulmeve ajrore të fillim vitit 2025 të Izraelit dhe SHBA-së për të neutralizuar kërcënimin që paraqesin për tregtinë ndërkombëtare, si dhe për interesat e SHBA-së dhe Izraelit në rajon. Çdo ditë vëmendja e medias kritikon pushtimin izraelit në Gaza, ndërsa opinionin publik luhet drejt vlerësimit të Izraelit si një agresor që po reagon me arrogancë dhe jo në mënyrë propocionale. Por sa më e gjatë dhe më e përgjakshme të jetë lufta në Gaza, aq më e vështirë bëhet për Izraelin që të vazhdojë të refuzojë idenë e një shteti palestinez.

Një nga mësimet që Shtetet e Bashkuara mësuan në Afganistan ishte identifikimi i armikut dhe më pas duhej të qëndronin të përqendruara vetëm tek ai armik. Edhe pse Osama bin Laden u vra vetëm 10 vjet më vonë, ai ishte neutralizuar efektivisht si kreu i përditshëm i Al Kaedës. Al Kaeda ishte një grup terrorist ndërkombëtar që kërkonte strehë të sigurt në Afganistan, ndërsa talebanët ishin një grup me rrënjë të thella në vend. Por, SHBA-të në vend që të përçanin dy grupet e ndryshme, i bëri ata aleatë dhe hyri në luftë me të dy.

Izraeli duhet të bëjë një dallim midis Hamasit dhe Autoriteti Palestinez (AP) pasi AP e ka njohur Izraelin dhe mbështet një zgjidhje me dy shtete. AP nuk e sulmoi Izraelin më 10/7 por e bëri Hamasi. Në fakt, një nga arsytet për përgjigjen e vonuar të ushtrisë izraelite më 10/7 ishte se forcat e caktuara më parë në komandën jugore pranë kufirit me Gazën ishin zhvendosur për të mbrojtur kolonët në Bregun Perëndimor. Në vazhdim, Izraeli duhet të pajtohet me AP dhe ta përdorë atë si një partner negociator për të izoluar Hamasin. Hapja e frontit të luftës kundër, Sirisë, Hezbollah, Houthi etj., e tejkalon shumë përqendrimin tek objektivi kryesor.

Dëshira për ndëshkim dhe përgjigje me forcë kundër një agresori është njerëzore. Por në kohë lufte dhe krize, udhëheqësit duhet të kenë durimin dhe kurajën për të menduar disa hapa përpara të tjerëve dhe për të marrë parasysh pasojat e veprimeve që ata ndërmarrin. Izraeli ka lindur nga tragjedia e Holokaustit dhe është betuar që “kurrë” të mos lejojë popullin hebre të jetë agresor. Duke e zbutur përgjigjen e tij ndaj 7 tetorit 2023 dhe duke shmangur grackat që përjetoi SHBA-ja gjatë luftës së saj të gjatë kundër terrorizmit, Izraeli duhet të arrijë zgjidhje kompromisi përballë palestinezëve dhe komunitetit ndërkombëtar, pasi Palestina do të jetojë përgjithmonë nën akuzën e një populli të shpronësuar dhe të pashpresë, që çdo ditë do të mendojë lëvizjen e ardhshme, për të mbijetuar. Fillimi i presidencës Tump pas datës 20 janar do të sjellë vlerësime dhe lëvizje gjeopolitike, të cilat analistët nuk i parashikojnë akoma, por leksionet amerikane për izraelitët unë mendoj se vlen të lexohen.



# POLICIA, INSTITUCIONI I PARË I SHTETIT TË ISMAIL QEMALIT



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

**M**e rastin e 112-vjetorit të krijimit të Policisë së Shtetit shqiptar (13.1.1913–13.1.2025), të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, të drejtuar nga Ismail Qemal Vlora. Policia e Shtetit me moshë e trajektore përtej shekullore, me pikënisje ideale kombëtare, mëkuar me gjakun e 226 dëshmorëve, e 422 të rënëve, ka qenë, është dhe mbetet përjetësisht, garancia e sigurisë publike shqiptare. Rrugëtimi i Policisë së Shtetit ka kaluar përmes suksesesh, sfidash, arritjesh ndonjëherë dhe dështimesh, përmes gjakut dhe sakrificash, megjithëse sot Policia është e aftë të përmbushë misionin e saj ligjor “Për Policinë e Shtetit”: “ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, parandalimin dhe luftën ndaj kriminalitetit, garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e jetës e të pronës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në përputhje me Kushtetutën e aktet ndërkombëtare”.

Në rrugëtimin e ngritjes së institucioneve të shtetit shqiptar, pas krijimit të Ministrive të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, ngritja e Policisë së Shtetit ishte “institucioni i parë pas Pavarësisë shqiptare”, më 13 janar 1913 në Vlorë. Rendi dhe qetësia publike në Shqipëri ishte meraku i Ismail Qemalit që më 2 nëntorin e vitit 1912, kur u nis nga hoteli “Pera Palace” të Stambollit drejt Shqipërisë, për shpalljen e pavarësisë së shtetit të fundit të Ballkanit. Pavarësia e Shqipërisë, zgjedhja e organeve ekzekutive e legjislativë të shtetit, më 1912-ën ishin aktet sublimë dhe domosdoshmëri jetike në katrahurën ballkanike e europiane të fillim shekullit XX. Kryetari i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali njoftoi gjashtë Fuqitë e Mëdha: Anglinë, Italinë, Austro-Hungarinë, Francën, Gjermaninë dhe Rusinë, për këtë akt madhor dhe vendimtar të shqiptarëve. Diplomatikisht u njoftuan edhe shtetet ballkanike si: Rumani, Mali i Zi, Serbi, Bullgari, Greqi e Turqi, duke iu kërkuar njohjen e pavarësisë, që ishte vullneti i gjithë shqiptarëve. Më 28.11.1912, Ismail Qemali u shpall kryetar i Kuvendit dhe kryetar i parë i qeverisë së shtetit shqiptar. Pavarësia u shpall për të gjitha trojet shqiptare. Ministrat u përzgjedhën nga të gjitha trevat shqiptare. Pavarësia përbënte aktin madhor dhe ngjarje kulmore në historinë e shqiptarëve, fryt i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të të gjithë shqiptarëve, për tërësinë tokësore dhe krijimin e shtetit të pavarur. Me vendimin e Kuvendit të Vlorës, kombi shqiptar fitoi të drejtën e tij të pamohueshme për të qenë i lirë e i pavarur, krahas kombeve e popujve të tjerë të Evropës. Vetëm një javë më vonë u formatua qeveria, ndërkohë që nevojë imediate ishte rendi, qetësia dhe siguria e brendshme. Rendi dhe qetësia ishte një prej obligimeve themelore të qeverisë së Vlorës. Ndjenja patriotike ishte pishitari i ndezur i atdhetarisë për t’u mbrojtur nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme. Policia e Shtetit është struktura që e kërkon koha në të gjitha epokat. Krijimi i policisë së shtetit për herë të parë u bë bazuar në vizionin e themeluesit të shtetit, i cili në ditët e para të 1913-ës thoshte: “...siguroni sa më mirë qetësinë e vendit dhe rendin publik...”, porosiste Kryeministri Ismail Qemali prefekturat dhe bashkitë e vendit. Në funksionin administrativ policor, drejtor i parë ishte Halim bej Gostivari. Për herë të parë në një qeveri shqiptare nisi të funksiononte Zyra e Sigurimit Publik, që thënë ndryshe ishte Drejtoria e Policisë Shqiptare, me detyra administrative dhe gjurmuese, ndërkohë që shkollimi ngeli një ide në letër. Më 13 janar 1913, Qeveria e Përkohshme e Vlorës mori vendimin për krijimin e Forcave të Rendit, të Policisë dhe Xhandarmërisë, (AQSH, Fondi dokumentar nr. 245/II, viti 1913, dosja 69, f.1,2.). Detyrat e Kryeministrit të parë dhe Kuvendit të Vlorës, për rend e qetësi publike do kryheshin nga xhandarmëria që kryente funksione të policimit dhe drejtohej nga Sali Vranishti, Alem Tragjasi, Hysni Toska, Hajredin Hekali. Katër muaj më vonë, më 4.5.1913, u krijua Shtabi madhnuer, që varej xhandarmëria me tre batalione: të Vlorës, Beratit e Elbasanit. Më 3.6.1913 u miratua “Rregullorja e Milicisë shqiptare të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës”, një dokument i rëndësishëm për kohën. Më 20.12.1913, doli dekreti i Qeverisë së Vlorës mbi Formimin e Xhandarmërisë shqiptare në krahinat e jugut, ku për organizimin e xhandarmërisë shqiptare një ndihmesë të konsiderueshme ka dhënë edhe Misioni holandez i kryesuar nga De Weer që erdhi në fund të tetorit 1913, në Shqipëri. Shqiptarët bazuar dhe të rekomandimet e xhandarmërisë holandeze krijuan 4 reparte xhandarmërie me 300 xhandarë secili. Në një periudhë prej një shekulli dhe dymbëdhjetë vjet Policia e Shtetit ka pasur historikun e zhvillimit, në përputhje me politikat shtetërore të disa regjimeve republikane, monarkike, socialiste



e demokratike, në periudha edhe nga më komplekset. Policia ka qenë domosdoshmëri jetike e shtetit, kërkesë e publikut, për misionin themelor në shërbim të rendit, qetësisë, sigurisë, komunitetit, zbatueshmërinë ligjore. Organizimi i parë i Policisë u bë në bazë drejtorie dhe ishte me qendër në Vlorë. Drejtuesi i parë i policisë shqiptare në shtetin e Ismail Vlorës ishte Halim bej Gostivari nga Gjakova, më tej Fehmi Mezhgorani nga Tepelena. Identifikimi i mbiemrave të drejtorëve fillimisht flet për gjeografinë e hapësirës gjithëshqiptare nga vinin drejtuesit e institucioneve në fillim të shekullit të kaluar, edhe përtej hapësirës administrative të “Shqipërisë londineze”. Fakt është se, Policia Shqiptare është ngritur nga vetë shqiptarët dhe më vonë edhe është mbështetur e këshilluar nga ekspertë e specialistë holandezë e më tej britanikë, edhe pse janë ruajtur tiparet, identiteti i misionit civil të Policisë, formati i evropian, por dhe me norma juridike për gjurmimin, hetimin, arrestimin, mbrojtjen e të drejtave e të lirive të individit, ndalimet e hyrjeve me forcë në shtëpitë e qytetarëve, grumbullimet pa armë etj.

## Përvojat botërore të policimit dhe xhandarmërisë dhe fryma e policimit shqiptar

Detyra emergjente e sigurisë së brendshme të shtetit, strukturimi mbi bazën e eksperiencave botërore të policimit ishte parësore për kohën. Ndërkohë që europianët, ballkanasit dhe më gjerë kishin dekada që ecnin në “shinat” e sigurisë së brendshme të shteteve. Europianët e njihnin anglezin Robert Peel, nismëtarin për miratimin mbretëror britanik të Aktit të Policisë Londineze të 19 qershorit 1829. Ai vendosi policinë e Londrës nën kontroll, si një zgjidhje për shkak të frikës së publikut në lidhje me vendosjen e forcave të ushtrisë në çështjet e brendshme. Sekretar i Brendshëm Robert Peel ishte i pari në botë që organizoi forcën policore përgjatë linjave civile, në vend të forcave paramilitare. Për t’u dukur neutrale, uniforma ishte porositur e prodhuar qëllimisht në ngjyrë blu, sesa e kuqe, e cila ishte atëherë një ngjyrë ushtarake, bashkë me oficerët të armatosur vetëm me një shkop druri dhe një raketë sinjalizuese për nevojën për ndihmë në rast rreziku. Radhët e policisë për kohën nuk përfshinin tituj ushtarakë, me përjashtim të gradës së rreshterit. Forca policore prej 1000 djemsh, ose “Bobsat”, për nder të krijuesit të tyre, Robertit, nuk mbante armë zjarri, edhe pse Robert Peel autorizoi Komisionerin të blinte pesëdhjetë pistoleta xhepi, për t’u përdorur në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhet për rastet e përdorimit të armëve të zjarrit. Karakteristikat e bobsave në sytë e publikut ishin “helmeta, shkopinj, bilbili”. Në Londër, dhe jo vetëm, vjedhjet ose thyerjet e shtëpive, ishin një problem i zakonshëm për policinë. “Shkelësit e shtëpive” ishin zakonisht të armatosur. Atëherë ishte gjithashtu e ligjshme, sipas projektligjit të të drejtave, për anëtarët e publikut që ishin protestantë, siç ishin shumica, të zotëronin dhe të përdorin armët e zjarrit. Pas vdekjes së oficerëve me armë zjarri në rrethet e jashtme të metropolit dhe debatit publik për armatosjen e forcës, Komisioneri i kërkoi Robert Peel për autorizim për të furnizuar oficerët në rrethet e jashtme me revolverë. Autorizimi u dha me kushtin që revolverët të lëshoheshin vetëm nëse, sipas mendimit të oficerit të lartë, oficerit mund t’i besohej ta përdorte me siguri dhe me përgjegjshmëri të lartë. Britaniku Robert Peel në mendjen e njerëzimit ka ngelur si “babai” i policisë së botës. Eksperiencia britanike u përhap në mbarë botën, edhe në Shqipëri, që kishte aspirata të mëdha të shtetformimit. Tiparet e policimit në vendin tonë i përhapu edhe grupi i xhandarmërisë holandeze me De Veerin në krye. Pas viteve ’20-të vështrimi u hodh edhe përtej kufirit administrativ shqiptar dhe në maj

1923, Kolonel Sterling mbërriti në Shqipëri. Më 29.9.1926, vendin e inspektorit të përgjithshëm, që mbante gjenerali anglez Frank W. Sterling, e zuri gjenerali anglez Perssi. Më 1933, në krye të Xhandarmërisë ishte nënkolonel Shefki Shatku, oficer i përgatitur dhe i arsimuar në kohën e mbretërisë së brishtë shqiptare në ndihmë të Xhandarmërisë, kishte në dispozicion gjeneralin anglez në pension Perssi. Policimi në Shqipëri kishte kaluar në rrugë “të pashkelura”. Misionin e policimit e kryente Garda dhe Xhandarmëria shqiptare, si elementë të sigurisë së brendshme deri në prill 1939, kur pushoi funksionin me pushtimin e vendit. Misioni i policimit i Xhandarmërisë më 1936 kishte një kolonel, katër nën/kolonelë, 8 majorë, 16 kapitenë të I, 32 kapitenë të II, 40 togerë, 43 nëntogerë, 144 oficerë gjithsej me buxhet të përgjithshëm 3.250.000 franga ari, që për kohën dhe forcën institucionale të shtetit të brishtë shqiptar ishte një shumë e konsiderueshme.

## Policimi në periudhën e ringritjes së institucioneve të pasluftës së Parë Botërore

Vitet ’20 janë vitet ku vendosej ardhmëria e shtetit shqiptar. Kongresi i Lushnjës, Lufta e Vlorës dhe pas konferenca e Versajës, ishin ngjarjet ku shqiptarët kaluan momentet më të rëndësishme historike të shtetformimit. Më 1919-1920, qeveria rivlerësoi rëndësinë e Policisë. Ajo organizoi Drejtorinë e Përgjithshme të Qetësisë Botore dhe u dha kompetenca nënprefekturave e prefekturave që të organizojnë zyrat e Policisë dhe të caktojnë policët në detyrë. Strukturat e Policisë u shtrinë në 14 nënprefektura, me efektiv prej 5 komisarësh, 8 nënkomisarësh, 43 policësh, që ishin emërtuar “komiseri”. Ishte hera e parë në historikun e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë pati buxhet financiar, që në nëntor 1919, buxheti u rrit 30% më 1920. Paga e punonjësve të policisë shënoi rritje me argumentin e përmirësimit të gjendjes dhe rritjen e ndërgjegjësimit e policëve të shtetit të rilindur shqiptar. Viti 1920 ishte viti i riorganizimit të Policisë shqiptare me drejtori policie në prefektura dhe shtimin e limitit organik të saj. Drejtorë të rinj të policisë dhe komisarë policie të rinj ishin sikurse administratorët vendorë e drejtuesit në strukturat e xhandarmërisë, ushtrisë e milicisë. Më 1921, roli i Policisë u fuqizua dhe iu kushtua kujdes i posaçëm i aftësimit për kryerjen e veprimeve procedurale që në çastin e njoftimit për ngjarjen, ndjekjen me shumë përgjegjësi të ngjarjeve kriminale dhe dokumentimin rigoroz në një raport në çdo dy javë. Kontrolli i territorit ishte detyrë bazale. Në metodën e policimit u kufizua e drejta e veprimit arbitrarisht ndaj individëve.

## Policia e Xhandarmëria shqiptare nga vitet ’20 të fillim shekullit të kaluar deri në pasluftën e Dytë Botërore në Shqipëri

Policimi shqiptar në gjysmë shekulli (1920-1990) eci në tre regjime. Në vitet 1927, 1928 u bënë përpjekje për organizimin e Policisë Shqiptare sipas modelit italian, për zbatim të ligjit për Administratën Civile, duke synuar dhënien e të gjithë kompetencave prefektit për kontrollin e policisë. Në dhjetëvjeçarin 1928-1938 policia dhe xhandarmëria ka pasur zhvillime pozitive, ku futën elementë modernë perëndimor në fushën e strukturave dhe legjislativitetit të policisë e xhandarmërisë; krijohen për herë të parë, policia bashkiake më 1928, policia rurale më 1929, policia kufitare më 1930, policia e sigurimit publik më 1938, roja mbretërore e kufirit më 1939, xhandarmëria qytetase me atributet e policisë urbane, etj. Periudha e viteve 1939-1944 ishte në peshën e LIIB, ndërsa Policia në më të shumtën ishte strukturë e qetësisë e rendit në rrethana specifike të luftës. Fillimisht ajo ishte pjesë e trupës së armatosur e Policisë në Shqipëri, në varësi të kryesisë së Këshillit të Ministrave, por e inkuadruar në trupën policore të Mbretërisë së Italisë. Në strukturën organizatave spikatin



gradën policore 'Drejtues Madhor'. Ka kryer studimet në Akademinë e Policisë në vitet 2002-2005, Tiranë, duke e përfunduar Akademinë me rezultate të shkëlqyera dhe më pas, ka kryer studimet e larta edhe në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkollën e Avokatisë në Tiranë. Ilir Proda ka kryer trajnime, kualifikime e specializime të shumta në fusha të ndryshme të edukimit policor brenda dhe jashtë vendit. Në gusht të vitit 2005, ka nisur karrierën si specialist i Policisë Kriminale; në gusht 2005 - nëntor 2011 në Komisariatin e Policisë nr.3 në Tiranë; nga nëntori 2011 deri në mars 2012 në Komisariatin e Policisë nr.4 në Tiranë; në mars 2012 deri në qershor 2013 në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së shtetit, seksioni kundër krimeve ndaj jetës dhe lirisë së personit; në qershor 2013 deri në tetor 2013 në Policinë e Lezhës; në tetor 2013 deri në dhjetor 2014 Shef Komisarati nr.2 në Tiranë; nga dhjetori 2014 deri në shkurt 2016 Shef Komisarati në Bulqizë, nga shkurti 2016 deri në maj 2017 në Seksionin për hetimin e narkotikëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga maji 2017 deri në korrik 2019 në Drejtorinë e Përgjithshme, Njësia për hetimin e krimeve kundër personit dhe pasurisë, nga korriku i vitit 2019 deri në tetor 2021 zëvendësdyrektor për hetimin e krimit në Korçë; nga tetori 2021 deri në mars 2023 zëvendësdyrektor për hetimin e krimeve në Elbasan; nga muaji mars 2023 deri më 2.10.2024 Drejtor i Drejtorisë Vendore i Policisë së Elbasanit; ndërsa aktualisht përmes një konkurrimi të hapur për Drejtor të Përgjithshëm të PSH është emëruar me VKM të datës 2 tetor 2024. Ilir Proda e fitoi detyrën e lartë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përmes një gare të hapur me konkurrentë të tjerë potencialë. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Ilir Proda është zgjedhur, më datën 14 dhjetor të vitit të kaluar (2024) president i SEPCA-s (Shoqata e Shefave të Policisë të Evropës Juglindore).



Shpesh dëgjojmë të flitet për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, tema të cilat kanë bashkëshoqëruar tranzicionin demokratik të Shqipërisë nga vitet '90 e këtej. Në tri dekada, Shqipëria ka bërë hapa përpara duke plotësuar kuadrin ligjor me elementet e nevojshme për garantimin e të drejtave të njeriut dhe kundër diskriminimit, duke ndërtuar institucione për mbikëqyrjen e zbatimit të të drejtave, si dhe janë ndërmarrë fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi për të ndryshuar mendësitë e prapambetura dhe stereotipet gjinore e praktikat e dëmshme që pengojnë përparimin e grave dhe vajzave në shoqëri.

Prej vitit 2008, vendi ka një Ligj për Barazinë Gjinore, ndërkohë që Ligji kundër Dhunës në Familje (2006) është ndryshuar herë pas here për të ofruar më shumë mbrojtje për gratë dhe vajzat, të cilat përbëjnë dhe grupin më të rrezikuar nga dhuna. Vendi ka në fuqi një strategji 10-vjeçare për arritjen e barazisë gjinore. Shqipëria ka ratifikuar konventa të rëndësishme si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe së fundi ajo e ONP-së për diskriminimin dhe ngacmimin në vendin e punës.

Në disa fusha të tjera, si p.sh. për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, Shqipëria është lider në rajon për sa i përket zbatimit të politikave financiare të përgjigjshme për gratë dhe vajzat.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit janë ndër institucionet që kanë krijuar një profil të qëndrueshëm në arenën e institucioneve garantuese të të drejtave të njeriut. Në vend veprojnë një numër i madh organizatash të shoqërisë civile, ku spikatin ato që merren me të drejtat dhe fuqizimin e grave.

Mënyra se si e kalojnë kohën e lirë gratë, si dhe angazhimi e vendi që ato zënë në jetën sociale, lidhet ngushtësisht me jetesën familjare dhe modelet e transmetuara prej fëmijërisë. Një nga faktorët që pengojnë përparimin e grave në shumë fusha të jetës ka të bëjë me pamundësinë për të investuar në lidhje me dëshirat, talentet, arsimimin, kualifikimin dhe rritjen profesionale, pikërisht për shkak të mungesës së kohës, si rrjedhojë e roleve stereotipike gjinore mbi përgjegjësitë e shumta për mbarëvajtjen e jetës familjare.

Si rrjedhojë e detyrimeve dhe përgjegjësiave për t'u kujdesur e për të mbuluar nevojat e të gjitha/gjithë anëtarëve të familjes, gratë dhe të rejat (e jo rrallëherë edhe vajzat), e kalojnë kohën e tyre duke iu përkushtuar gjithë aktivitetit të përkujdesjes brenda familjes, aktivitet ky që shumë pak ose aspak njihet dhe vlerësohet. Kjo bën që, nga ana tjetër, gratë dhe vajzat të kenë shumë më pak kohë të lirë për t'ia kushtuar vetes dhe aktiviteteve që u sjellin kënaqësi, apo për të investuar në dijet e tyre, për të marrë një profesion, apo për t'u rritur profesionalisht.

Sigurisht që në këtë drejtim ndikojnë edhe një sërë faktorësh të lidhur me nivelin arsimor, statusin civil, vendbanimin, numrin e fëmijëve, jetesën në familje të mëdha, nivelin ekonomik, modelin e familjes së origjinës e të tjera. Pa dyshim që edhe zhvillimi tërësor i shoqërisë dhe përparimi në drejtim të njohjes, pranimi dhe respektimit të të drejtave njerëzore të grave, ka ndikimin e vet pozitiv në këtë drejtim. Sot nuk mund të quhet e pamundur që një grua të ketë mundësinë t'i kushtojë kohë vetes së saj e për më tepër të vendosë se me çfarë aktiviteteve do ta kalojë kohën e lirë. Patjetër që nëse kjo grua jeton në qytet ka më shumë mundësi të mendojë për kohën e lirë dhe për mundësitë se si do ta kalojë atë. Po kështu, ndryshe e planifikon kohën e saj të lirë një e re dhe ndryshe një nënë me fëmijë të vegjël apo me një person që ka nevojë për përkujdesje (qoftë e/i moshuar, qoftë me aftësi të kufizuara ose me probleme shëndetësore etj).

**Është e vështirë të jesh grua.  
Duhet të mendosh si burrë,  
Të veprosh si zonjë,  
Të dukesh si vajzë  
Dhe të punosh si kalë.**

#### Perceptim apo konstatim

Në jo pak raste, kur në shoqërinë tonë hapen debate mbi barazinë gjinore, vihet re tendenca për t'i vendosur gratë në pozicione të pafavorshme dhe për të njëtrajtësuar veprimtarinë ndërmjet tyre dhe burrave, nëse një grua kërkon barazi, atëherë le të përballojë të gjitha punët e krahut që përballon një burrë, nëse një grua pretendon se është e aftë, atëherë le ta tregojë

# TË JESH GRUA është mision pa fillim dhe fund



këtë aftësi duke u përballur me burrat e duke i zgjidhur situatat ashtu si ata, nëse një grua kërkon të ndihet e respektuar, le ta provojë “burrërinë e saj”... pra, barazia ngatërrohet e zëvendësohet me njëtrajtshmërinë. Kjo barazi e njëtrajtësuar nuk mundet dhe nuk duhet të zërë vend si normë krahasuese as ndërmjet grave, të rejave, vajzave dhe burrave, të rinjve e djemve dhe as ndërmjet vetë grupeve të grave, të rejave e vajzave apo ndërmjet vetë grupeve të burrave, të rinjve e djemve. Edhe kur i përkasim së njëjtës gjini, nevojat, interesat, mundësitë dhe pritshmëritë tona ndryshojnë dhe lidhen me një sërë karakteristikash individuale.

Barazia gjinore dhe drejtësia gjinore duhet të zënë vend dhe të zbatohen që në marrëdhëniet brenda familjes. Për këtë nevojitet të punohet në drejtim të zvogëlimit të stereotipeve dhe roleve gjinore, të cilat ushqejnë pabarazitë në marrëdhëniet familjare, sociale e më gjerë. Edukimi që në fëmijërinë e hershme mbi bazën e parimeve të barazisë e mosdiskriminimit gjinor e të shumëfishtë, është një nga mënyrat më efikase, e cila duhet kombinuar me dhënien e sa më shumë modeleve pozitive, me profesioniste e profesionistë të edukimit të mirëtrajnuara/mirëtrajnuar e të ndjeshme/ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore, me kurrikula e tekste shkollore të të gjitha niveleve arsimore të përgatitura me ndjeshmëri gjinore, me një tërësi emisionesh televizive apo spotesh e artikujsh në mediat sociale, si dhe me politikat e duhura, të cilat duhen zbatuar përmes vënies në dispozicion të burimeve të nevojshme njerëzore, financiare e infrastrukture.

Rritja e aksesit të grave në tregun e punës dhe punësimi i denjë janë domosdoshmëri nëse duam të përparojmë në drejtim të fuqizimit të grave dhe arritjes së barazisë gjinore.

Ndarjet gjinore të punës që ndikojnë në brendësimin e modeleve të gabuara të punëve të përcaktuara “vetëm për gratë” apo “vetëm për burrat”, identifikohet lehtë fakti që profesionet ku gratë aftësohen kryesisht, por edhe ku shoqëria pret t'i shohë më së shumti, shkojnë në linjë me rolet dhe ndarjen gjinore të punës. Vajzat, të rejat dhe gratë përgjithësisht edukohen dhe aftësohen për t'u angazhuar në

punë të lidhura me përkujdesjen, edukimin, pastrimin e rregullimin dhe shihen si më “të afta” në pozicionet e specialistes, edukatores, mësueses së arsimit fillor apo të lëndëve shoqërore, infermieres, sanitares, mjekes së familjes, shitëses, arkëtares, parukieres etj., sepse këto profesione përgjithësisht konsiderohen si delikate, që nuk kërkojnë përdorim të forcës fizike dhe mbi të gjitha përputhen me “natyrën delikate të përkujdesjes” që karakterizon një vajzë, të re apo grua, të lidhur ngushtësisht me instinktin e “mëmësisë”. Edhe pse ndër vite këto qëndrime stereotipike të ndarjes së profesioneve janë sfiduar, ende një e re apo grua në pozicione drejtuese, politikane, menaxhere, sipërmarrëse, shkencëtare, kirurge, specialiste e TIK-ut etj., shihet me skepticizëm e jo gjithmonë besohet, mirëpritet e mbështetet.

Gratë përgjithësisht edukohen (që në fëmijërinë e tyre) dhe aftësohen për t'u angazhuar në punë që lidhen me përkujdesjen dhe edukimin, sepse trajtohen me paragjykim si qenie “të brishta” e “të paafta për të kryer punë të tjera”.

Nëse punësohen, familja përgjithësisht pret që ato të punësohen në punë me orar fiks dhe mundësisht më të shkurtër sesa tetë orë, me qëllim që të jenë gjithmonë pranë familjes, duke mbajtur përgjegjësinë kryesore për të pritur e përcjellë, për të shërbyer vaktet ushqimore, për t'u kujdesur për fëmijët dhe familjarët e tjerë.

Ndarja gjinore e punës brenda marrëdhënieve familjare i mban shpesh gratë larg tregut të punës apo larg ëndrrave të tyre për punësim dhe aftësi. Nënata me fëmijë të sapolindur apo nën moshën trevjeçare, sikurse dhe nënat me më shumë sesa një fëmijë, e kanë më të vështirë të punësohen dhe të kenë një punë të qëndrueshme. Kjo lidhet pikërisht me rolin që u është paracaktuar atyre në familje në përputhje me ndarjen gjinore të punës për rritjen e kujdesin ndaj fëmijëve.

E me gjithë barrierat social-ekonomike gruaja shqiptare ja ka dalë të mbajë mbi supet e brishtë gjithçka që ‘të fortët’ as do i mendonin. Kjo është forca e gruas, dimensionet e së cilës e kalojnë imagjinaren.

Të jesh grua është mision i vështirë, që vetëm kjo qenie mund ta realizojë pa dështuar.



# GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU KRYQTARI I FUNDIT



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

*Redaksia e gazetës “Ushtria” shpreh mirënjohje ndaj bashkëpunëtorëve të saj, historianë, akademikë, studiues, ish-ushtarakë dhe efektivë të Forcave të Armatosura për materialet e tyre me vlerë të padiskutuar.*

## Shënime për librin e Virgjil Kules

Mbase vjersha e parë që kam recituar kur isha në kopsht, 4-5 vjeç, ka qenë për një Gjergj të vogël që hipën mbi një kalë druri dhe duke vërtitur shpatën majtas-djathtas bërtiste krenar me të madhe: hej, hej, hej, unë jam Skënderbej! Por të gJORIT i ndodh një e papritur, një patok i del para dhe hap krahët. Gjergji shpejt e ul shpatën e fillon të qajë. Merret me mend që dikush aty përreth i thotë të bëhej burrë, të mbante lart shpatën, se Skënderbeu nuk e ulte atë kurrë!

Ky imazh i Gjergjit të madh, por mbi një kalë të vërtetë, të bardhë, madhështor e të bukur, me përkrenaren e famshme dhe shpatën gjithmonë lart, na ka ndjekur - sepse besoj se është një përfytyrim i gjithkujt që i thotë vetes shqiptar - gjithë jetën. Atë përfytyrim e ushqenin së pari literatura dhe artet e bukura, pikturat, skulpturat, filmat që lexonim e shikonim, por edhe këngët, rrëfenjat e më të rriturve. Barleti, Gavril Dara, Naimi, Longfellow, Noli, Akaki Khorava, Spiro Xega, Janaq Paço, Odhise Paskali e plot të tjerë, që gjithnjë na kanë dhënë një Skënderbej mbi kalë e me shpatën gati për të prerë kokat e osmanëve.


Dhe ja ku vjen një bandë historianësh të një lloji tjetër, që na tregojnë një tjetër, krejt tjetër Skënderbej. Na tregojnë se Gjergji ynë ishte edhe më i madh, edhe më i bukur, edhe më i zgjuar, edhe më gjenial, madje edhe më modern se ai që mbanim në përfytyrimin tonë.

Kristo Frashëri, Aurel Plasari, Oliver Shmidt, Shahin Leka, e bashkë me ta edhe Virgjil Kule na zbulojnë dimensionet e plota ose pothuaj të plota të Gjergjit tonë.

Më kujtohet disa vjet të shkuara që u ngrit një furtunë ‘fejsbukasish’, kur Ardian Klosi u përcolli lexuesve Historinë e Skënderbeut të Shmidtit. Zemërimi i patriotëve të FB u vërtit e u derdh kundër idesë së çmitizimit të Skënderbeut, për ta paraqitur atë më të vërtetë, më njerëzor. Por jo! Atdhetarët nuk mund të pranojnë të preket figura e Heroit të Kombit! Ai ndriçon e shkëlqen pa asnjë shenjë njeriu të zakonshëm, pale të ketë bërë gjëra që i bëjnë vetëm të vdekshmit.

Ata nuk e dinë, dhe s’kanë si ta dinë, pasi të lexuarit është ‘sport i vështirë’, që më 1504 Gjon Muzaka i ka bërë një portret real dhëndrit të motrës së tij, e mes himneve e lavdeve, flet edhe për rrëmbime pronash me majën e shpatës ndaj princërve të tjerë shqiptarë. Por ata që kanë parë nga poshtë vetëm monumentin në qendër të Tiranës s’kanë si të pranojnë që Skënderbeu është produkt i kohës kur jetoi e luftoi.

Tani unë do të kapem tek kjo shprehje: Produkt i kohës së tij. Tek si produkt që na ka portretizuar Virgjil Kule. Është padyshim një nga librat më të bukur që janë botuar për Gjergj Kastriotin, Skënderbeun. Dhe me sa di unë, në krejt literaturën historike shqiptare e botërore skënderbejane, diçka krejt origjinale. Për faktin se studimi na e sjell Heroin në një kronikë të mirëfilltë Historike. Ai e përshkruan atë dhe aksionin çlirimtar, mbrojtës e kryqtar të tij muaj pas muaji, vit pas viti e ngjarje pas ngjarjeje, çka detyrimisht na bën të shohim e të njohim një Skënderbej jo vetëm



të aksionit luftarak, por edhe në përmasat politike, diplomatike dhe shtetformuese.

Virgjili merret me përgatitjet e betejave dhe pasojat e tyre, por anashkalon kryqëzimin e shpatave dhe prerjet e kokave, fluturimin e shigjetave dhe sulmet, tërheqjet, zjarret e rrethimet. Me të tjera fjalë, në 933 faqet e librit ne gjejmë burrin e shtetit dhe strategun ushtarak, diplomatin, mendimtarin, atdhetarin dhe europianistin, kemi të fundmin e një Historie që kish filluar më 1096-n me Kryqëzatën e Parë për të çliruar e mbrojtur varrin e Krishtit, histori që u shua gradualisht me vdekjen e tij.

Autori, duke filluar nga kthimi i Skënderbeut në Krujë, më 28 nëntor 1443, deri, më 17 janar 1468, merret me defterët e Skënderbeut e për Skënderbeun, përpiket të kuptojë dhe të na tregojë se ia arrin qëllimit me sukses, çfarë zien në kokën e këtij njeriu, pse vendosi të bëjë të pabërën, d.m.th. luftë me superfuqinë e kohës, por edhe me fuqi më të vogla, por jo më pak të rrezikshme. Ku dhe si e gjeti atë logjikë dhe atë fuqi mendimi për t’i hyrë dy misionëve të jashtëzakonshme e fisnike, shpëtimit të Krishterimit dhe bashkimit të principatave shqiptare në një Mbretëri Arbërore të Krishterë?

Ne e dimë dhe autori na e sqaron edhe më bindshëm që në plan afatshkurtër ai nuk i realizoi plotësisht ato, ndoshta edhe se vdekja e mori në moshë relativisht të ri, por në radhë të parë, siç e ka dokumentuar saktë kronikani Virgjil, sepse rrethanat asnjëherë nuk u përputhën me planet, taktikat dhe strategjinë e tij. Le të përmendim goditjet që planet dhe aspiratat e Skënderbeut morën me vdekjen e Papës Piu II, në momentin që ai u nis në krye të Kryqëzatës dhe në

dosjen e tij kish shpalljen e Gjergj Kastriotit Mbret të Shqiptarëve dhe Kryekomandant të Kryqëzatës. Po ashtu, të përmendim tradhtitë e shumta dhe lojërat pas shpine të shtetarëve italianë, princërve dhe mbretërve ballkanas dhe deri jo vetëm princërve shqiptarë, por edhe familjarëve dhe krushqve të tij.

Por në plan afatgjatë, fakti që flasim për të, fakti që 150-180 vjet më parë Rilindasit shqiptarë ndërtuan një projekt perëndimor për kompaktësimin e Kombit Shqiptar dhe krijimit të Shtetit Shqiptar rreth emrit dhe Flamurit të Skënderbeut, fakti që Italia dhe Europa mbetën të Krishtera, madje dhe Europa Juglindore nuk u islamizua plotësisht, fakti që bibliografia dhe seriali i veprave letrare, artistike e historike për emrin dhe bëmat e tij arrijnë shifra marramendëse, tregojnë se ç’ gjeni të mendimit e të veprimit ka rritur toka e shqipeve.

Sigurisht, përtej legjendave e miteve që na tregojnë se Vojsava e dinte që kur e kish në bark se do të lindte një dragua, se Zoti i tha në ëndërr etj.

Virgjil Kule na tregon nëpërmjet udhëtimit së bashku me lexuesin në shekullin XV, duke shqyrtuar faktet dhe dokumentet e asaj kohe dhe pastaj, siç thotë autori, vetë lexuesi të shkruajë historinë e Heroit. Të bësh lexuesin bashkë-shkrues të një historie të tillë të jashtëzakonshme, nuk është një nismë dhe përpjekje e lehtë, madje është edhe një risi në literaturën shqiptare të shkencës historike, por si një “shofer i mirë i kohës” siç dhe e quan veten autori, ka ditur të manovrojë me sukses dhe të mbërrijë në destinacion, duke merituar duartrokitjet e lexuesve, ose bashkë-shkruesve siç edhe ai thotë. E kam fjalën që lexuesi, në këto kohëra kur leximi disave u duket si shfaqje e huaj, nuk trembet e as lodhet nga një libër i tillë voluminoz. Jo vetëm se subjekti është tërheqës, por edhe se stili, kultura e të shkruarit, thjeshtësia dhe qartësia e ndërtimit të frazës dhe tekstit, shqipja e

pastër, të gjitha këto e bëjnë librin më tepër një shok që të tregon diçka të bukur, sesa një stivë fletësh që edhe t’i numërosh, lodhesh. Tradita e shkrimeve si ky e do që të bëhet edhe ndonjë vërejtje, por Virgjili nuk na ka lënë shteg të ndjekim traditën.

Dhe për ta mbyllur, edhe diçka të fundit. Lexuesit e gazetës USHTRIA pothuaj të gjithë e ndoshta më shumë se gjithkush kanë lidhje me emrin e Gjergjit të Madh. Ne u shkolluam në Shkollën me emrin e tij, më të moshuarit që në moshën 14-15 vjeç e më të rinjtë 18-20-vjeçarë. Por duke lexuar Prologun e “Kryqtarit të Fundit”, bie në sy që në atë moshë, mbase dhe më i vogël, edhe Gjergji që tashmë quhej Skënder, duke trashëguar emrin e paraardhësit të tij zulmëmadh, Aleksandrit të Madh, kaloi në të njëjtën përvojë ose, që të jem i saktë, ne kaluam në përvojën e tij.


“Skënderit të vogël, - shkruhet në f. 14, - si gjithë të tjerëve i caktohet një shtrat... i dorëzohet takëmi i rrobave... këmbalet mbulonin pjesën e sipërme të këpucëve... në trup vishte një këmishë me mëngë të gjata, pa jakë, e cila mbërthehej me një kopsë vetëm në rrethin e qafës duke lëmë një vijë të hapur në gjoks...etj”.

Të dashur lexues, ju kujtojnë gjë këto hollësi të veshjes së Skënderit të vogël?

Sigurisht. Prandaj nuk ka çudit që ndihemi kaq të lidhur me këtë emër.

Prandaj dhe Virgjil Kule meriton një falënderim të veçantë nga lexuesit e kësaj gazete. Dhe patjetër nga kushdo që jo vetëm e lexon. Pasi do të thoshim se është libër i domosdoshëm i çdo biblioteke personale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES

# QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT,

do të rekrutojë **1 (NJË)** kandidat për të ndjekur: “Kursin fillestar të Oficerit të Forcës Detare”, i cili do të zhvillohet në periudhën **8 shtator 2025-14 gusht 2026**, në Kolegjin Mbretëror të Forcave Detare në Dartmouth, në Britaninë e Madhe. Arsimi: “bachelor”, brenda ose jashtë vendit. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 11 shkurt 2025. Për më shumë informacion klikoni më poshtë:

<https://shorturl.at/a0JI6>